

VENDIM
Nr.765, datë 8.7.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT GLOBAL, PËR
PROGRAMIN “PËRSHKALLËZIMI I PËRGJIGJES KOMBËTARE NDAJ
TUBERKULOZIT” (FAZA E DYTË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Global, për programin “Përshkallëzimi i përgjigjes kombëtare ndaj tuberkulozit” (faza e dytë), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJA E GRANTIT E NDRYSHUAR DHE E RIFORMULUAR

1. Shteti: Republika e Shqipërisë		
2. Emri dhe Adresa e Përfituesit Kryesor: Instituti i Shëndetit Publik i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Rruga “Aleksandër Moisiu”, Nr. 80, Tiranë, Republika e Shqipërisë		
3. Titulli i Programit: Fuqizimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Tuberkulozit		
4. Numri i Grantit: ALB-506-G02-T		4A. Numri i Modifikimit: 6 (Ndryshimi i Fazës 2)
5. Data e Fillimit të Fazës 1: 1 Prill 2007	6.Data e Përfundimit të Fazës 1: 31 Mars 2009	7. Data e Përfundimit të Fazës 2: 31 Mars 2012
7A.Data e Fundit e Kushteve Paraprake: 1 Tetor 2006	7B.Data e Fundit e Kushteve Paraprake: 15 Maj 2007	7C.Data e Fundit e Kushteve Paraprake: 15 Maj 2007
7D.Data e Fundit e Kushteve Paraprake: 15 Maj 2007	7E.Data e Fundit e Kushteve Paraprake:	7F. Data e Fundit e Kushteve Paraprake:
8. Fondet e Grantit: US\$ 1,263,490 (Një Milion e Dyqind e Gjashtëdhjetë e Tre Mijë e Katërqind e Nëntëdhjetë Dollarë Amerikanë)		
9. Mbulimi i Programit: Tuberkulozi		
10. Informacion për Llogarinë bankare të Përfituesit Kryesor, në të Cilën do të Livrohen Fondet e Grantit: Zotëruesi i Llogarisë Bankare: Njësia e Zbatimit të Projektit, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik Emri i Llogarisë: Fuqizimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Tuberkulozit Numri i Llogarisë: 2117356U Emri i Bankës: Banka Kombëtare e Shqipërisë Adresa e Bankës: Sheshi “Skënderbej” No 1, Tiranë, Shqipëri Kodi Bankar SWIFT: STANALTR Kodi Bankar: N/A Udhëzime drejtimi për livrimet: Rezerva Federale e Nju Jork-ut, Kodi SWIFT: FRNYUS33, Llogaria Bankare e Bankës Kombëtare të Shqipërisë: 021088315		

11. Viti fiskal i Përfituesit Kryesor është nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor.	
12. Agjenti Lokal i Fondit: PricewaterhouseCoopers Pricewaterhouse Coopers Albania Blvd. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 10 të, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 42 242 254 Fax: +355 42 241 639 Për dijeni: Laura Qorlaze, Drejtoreshë e Zyrës në Shqipëri E-mail: laura.qorlaze@al.pwc.com	
13. Emri/Adresa e Njoftimeve për Përfituesin Kryesor: Dr. Edlira Shara, Koordinatore e Përgjithshme e Njesisë së Zbatimit të Projektit të FG-së Instituti i Shëndetit Publik Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 80, Tiranë, Republika e Shqipërisë Tel/Fax.: + 355 42 382 090 E-mail: elda.sharra@gmail.com	14. Emri/Adresa e Njoftimeve për Fondin Global: Dr. Urban Weber, Drejtues Ekipi Rajonal Ekipi i Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore Fondi Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarien Chemin de Blandonnet 8 1214 Vernier, Gjeneva, Zvicër Tel.: +41 58 791 1700 Fax: +41 58 791 1701
Kjo Marrëveshje përbëhet nga dy faqe të kësaj flete të dhënash dhe të pjesëve të tjera si më poshtë vijon: Terma dhe Kushte Standarde Aneksi A – Përshkrimi i Zbatimit të Programit dhe shtojcat e kësaj (përfshirë Kuadrin e Performancës dhe Buxhetin e Përmbledhur)	
15. Firmosur në emër të Përfituesit Kryesor nga Përfaqësuesi i tij i Autorizuar Data: Firma: _____ Dr. Anila Godo Ministre e Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë	
16. Firmosur në emër të Fondit Global nga Përfaqësuesi i tij i Autorizuar Data: Firma: _____ Prof. Michel Kazatchkine Drejtor Ekzekutiv	

MARRËVESHJA PËR PROGRAMIN E GRANTIT FAQE 3

PËRSHKRIM

~~(a)~~ a) Fondi Global nënshkroi me Përfituesin Kryesor Marrëveshjen e Grantit të Programit që hyri në fuqi me datën 20 Tetor 2006 për Numrin e Grantit të treguar në bllokun 4 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje të Ndryshuar dhe të Riformuluar për Programin (siç përshkruhet më poshtë) (“Marrëveshja Origjinale”);

~~(b)~~ b) Sipas Neneve 30 dhe 31 të Termave dhe Kushteve Standarde të Marrëveshjes Origjinale, Marrëveshja Origjinale u ndryshua me anë të letrave të zbatimit të datës 1 Shkurt 2007, 11 Prill 2007, 10 Gusht 2007 dhe 5 Mars 2008 dhe 8 Gusht 2008;

~~(c)~~ c) Neni 10. c i Termave dhe Kushteve Standarde të Marrëveshjes Origjinale shprehet se “Fondi Global nuk do të autorizojë livrimin e asnjë fondi tjetër të Grantit pas Datës Përfundimtare të Fazës 1 në rast se palët nuk e ndryshojnë këtë Marrëveshje për të pasqyruar Miratimin e Fazës 2 (siç përshkruhet në Nenin 3 (b) të kësaj Marrëveshjeje)”;

~~(d)~~ d) Fondi Global e ka dhënë miratimin e Fazës 2. Prandaj, në bazë të kushteve të caktuara, Fondi Global dëshiron: (i) të rrisë shumën e Grantit të dhënë në Marrëveshjen Origjinale; dhe (ii) të vazhdojë livrimin e fondeve të Grantit deri në “Datën e Përfundimit të Fazës 2” të treguar në Bllokun 7 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje të Ndryshuar dhe të Riformuluar; dhe

~~(e)~~ e) Fondi Global dhe Përfituesi Kryesor dëshirojnë: (i) të zëvendësojnë Termat dhe Kushtet Standarde të Marrëveshjes Origjinale me Termat dhe Kushtet e dhëna në vijim; (ii) të zëvendësojnë Aneksin A të Marrëveshjes Origjinale me Aneksin A të rishikuar bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje të Ndryshuar dhe të Riformuluar; dhe (iii) të bashkëlidhë dokumentet e titulluar “Kuari i Performancës Viti 3&4: Treguesit, Synimet dhe Periudhat e Mbuluara” dhe “Buxheti i Përmblodhur Viti 3&4” bashkëlidhur Aneksit A të kësaj Marrëveshjeje të Ndryshuar dhe të Riformuluar.

Prandaj, duke pasur parasysh marrëveshjet që përfshihen këtu dhe që synohet të jenë ligjërisht të detyrueshme, palët bien dakord në këtë mënyrë që të ndryshojnë dhe të riformulojnë termat dhe kushtet e Marrëveshjes Origjinale si më poshtë vijon:

ANEKSI A I MARRËVESHJES SË GRANTIT TË PROGRAMIT

Përshkrim i Zbatimit të Programit

Shteti:	Republika e Shqipërisë
Titulli i Programit:	Fuqizimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Tuberkulozit
Numri i Grantit:	ALB-506-GO2-T
Sëmundja:	Tuberkulozi
Përfituesi Kryesor:	Instituti i Shëndetit Publik i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Termat me shkronja të mëdha dhe shkurtimet që janë përdorur, por nuk janë përkufizuar në Aneksin A apo në shtojcat e Aneksit A kanë kuptimin që u është dhënë atyre në Termat dhe Kushtet Standarde të kësaj Marrëveshjeje.

Në rast konflikti ndërmjet termave të Aneksit A dhe çdo dispozite të Termave dhe

Formatted: Bullets and Numbering

Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë termat e Aneksit A.

A. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

1. Historik dhe Përmbledhje:

Në vitin 2004, incidenca e raportuar e tuberkulozit (TB) në Shqipëri ishte 20/100,000. Megjithatë, ka të ngjarë që kjo shifër nënvlerëson incidencën e TB-së në zonat e varfra rurale dhe te grupet e veçanta të përzgjedhura.

Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për kontrollin e TB-së bazohet në Strategjinë e rekomanduar të Trajtimit të Vëzhguar Direkt (STVD) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) për kontrollin e TB-së. Në vitin 2000, u krijuan zyrtarisht Programi Kombëtar për TB-në (PKT) dhe rrjeti laboratorik me financimin e Qeverisë Shqiptare. Treguesit Programatik, të tillë si niveli i ulët i zbulimit të rasteve, dhe diagnostikimi i vonuar, treguan disa mungesa me rëndësi kritike që duheshin trajtuar. Fondet e disponueshme në vend nuk mbështesin dot zbatimin e aktiviteteve kyçe për eliminimin e këtyre mangësive. Kështu që fondet e Programit të Fondit Global kontribuuan në mbylljen e boshllëkut financiar.

2. Objektiv:

Reduktimi i ngarkesës së TB-së në Shqipëri në atë shkallë që nuk përbën më një problem të shëndetit publik.

3. Grupet e Synuara/Përfituesit:

Popullsia më e prekur përfshin:

- Njerëzit e varfër që jetojnë në zonat veriore dhe verilindore të vendit, apo persona që migrojnë nga këto zona;

- Minoriteti Etnik i Popullsisë Rome;

- Të Burgosurit;

- Punëtorët emigrantë që kane akses të kufizuar në shërbimin shëndetësor jashtë shtetit; dhe

- Të rinjtë e papunë.

4. Strategjitë:

- Fuqizimi i sistemeve shëndetësore për kontroll më të mirë të TB-së;

- Zgjerimi dhe ruajtja e mbulimit 100% të STDV-së;

- Sigurimi i aksesit ndaj STDV-së nga grupet e prekshme;

- Parandalimi i infeksionit të kombinuar TB/HIV; dhe

- Përmirësimi i kontrollit të rezistencës ndaj ilaçeve.

5. Aktivitetet e Planifikuara:

- Ndërmarrja e aktiviteteve të promovimit të shëndetit dhe të edukimit të pacientëve te grupet e synuara e prekshme;

- Fuqizimi i njësive të koordinimit të STDV-së në qendër dhe në rrethe;

- Fuqizimi i rolit të mjekëve të përgjithshëm dhe i infermierëve si pika kryesore të kontrollit të TB-së;

- Trajnimi dhe krijimi i kapaciteteve të stafit mjekësor dhe shërbimeve;

- Fuqizimi i sistemit të regjistrimit dhe raportimit të STDV-së;

- Ngritja e një sistemi mbikëqyrjeje për TB-në;

- Zgjerimi i rrjetit të laboratorëve cilësisht të garantuar;

- Përmirësimi dhe zgjerimi i mbikëqyrjes së rezistencës të TB-së ndaj ilaçeve;

- Sigurimi i furnizimit të rregullt të ilaçeve cilësore për të trajtuar TB-në;

- Përmirësimi i zbulimit të rasteve në grupet e përzgjedhura;

- Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i objekteve të kujdesit shëndetësor dhe i laboratorëve;

- Blerja e pajisjeve dhe e furnizimeve laboratorike për mbikëqyrjen e rezistencës ndaj ilaçeve (MRI); dhe

- Ndërmarrja e aktiviteteve bashkëpunuese për TB/HIV.

B. KUSHTET PARAPRAKE NDAJ LIVRIMIT

1. Kushti/et Paraprake ndaj Livrimit të Parë në Fazën 1 (Data Përfundimtare siç shprehet

në bllokun 7A të Fletës të së Dhënave)

Livrimi i parë i fondeve të Grantit nga ana e Fondit Global për te Përfituesi Kryesor në Fazën 1 është subjekt i plotësimit të secilit prej kushteve të mëposhtme:

a) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global të një pasqyre që konfirmon detajet e një llogarie të veçantë bankare në të cilën do të livrohen fondet e Grantit siç tregohet në bllokun 10 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje;

b) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global e një letre të firmosur nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit Kryesor që përmban emrin, titullin dhe modelin e vërtetuar të firmës së çdo personi të autorizuar për të firmosur kërkesa livrimi në bazë të nenit 10 të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje dhe, në rast se një kërkesë livrimi firmoset nga më shumë se një person, kushtet sipas të cilave secili prej tyre firmos; dhe

c) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global i një evidence, sipas formës dhe përmbajtjes që është e përshtatshme për Fondin Global, që tregon se Përfituesi Kryesor ka kryer vlerësimin e kapacitetit të Njësisë së Zbatimit të Programit (NJZP), dhe ka shpallur njoftim për çdo pozicion që duhet të plotësohet brenda fushave funksionale të NJZP-së për të bërë të mundur që Përfituesi Kryesor të veprojë në përputhshmëri me detyrimet në bazë të kësaj Marrëveshjeje:

1. Menaxhim dhe administrim programi;
2. Menaxhim dhe kontabilitet financiar;
3. Menaxhim të prokurimit dhe të furnizimit; dhe
4. Monitorim e vlerësim.

2. Kushti/et Paraprake ndaj Livrimit të Dytë në Fazën 1 (Data Përfundimtare siç shprehet në bllokun 7B të Fletës së të Dhënave)

Livrimi i dytë i fondeve të Grantit nga ana e Fondit Global për te Përfituesi Kryesor është subjekt i plotësimit të secilit prej kushteve të mëposhtme:

a) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global i një manuali të operacioneve, sipas formës dhe përmbajtjes që është e përshtatshme për Fondin Global, që specifikon politikat dhe procedurat për sa më poshtë vijon:

1. Menaxhimin e Programit (duke përfshirë menaxhimin programatik të Nën-përfituesve);
2. Menaxhim dhe kontabilitet financiar (duke përfshirë menaxhimin dhe kontabilitetin financiar të Nën-përfituesve); dhe
3. Monitorim e vlerësim (duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e Nën-përfituesve);

b) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global i një evidence, sipas formës dhe përmbajtjes që është e përshtatshme për Fondin Global, që tregon se Përfituesi Kryesor ka fuqizuar kapacitetin e NJZP-së duke punësuar një numër të mjaftueshëm personash me kualifikimet dhe përvojën e përshtatshme për të plotësuar pozicionet në fushat funksionale të mëposhtme për të bërë të mundur që Përfituesi Kryesor të veprojë në përputhshmëri me detyrimet në bazë të kësaj Marrëveshjeje:

1. Menaxhim dhe administrim programi;
2. Menaxhim dhe kontabilitet financiar;
3. Menaxhim të prokurimit dhe të furnizimit; dhe
4. Monitorim e vlerësim.

3. Kushti/et Paraprake ndaj Livrimit për Nën-përfituesit në Fazën 1 (Data Përfundimtare siç shprehet në bllokun 7C të Fletës të së Dhënave).

Livrimi i fondeve të Grantit nga ana e Përfituesit Kryesor për tek Nën-përfituesit në Fazën 1 është subjekt i plotësimit të secilit prej kushteve të mëposhtme:

a) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global i një evidence, sipas formës dhe përmbajtjes që është e përshtatshme për Fondin Global, që tregon se Përfituesi Kryesor ka vepruar në përputhje me Nenin 14 (a) të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj

Marrëveshjeje gjatë vlerësimit dhe zgjedhjes së Nën-përfituesve; dhe

b) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global i një kopjeje të marrëveshjes standarde të grantit të Përfituesit Kryesor për Nën-përfituesin/t.

3. Kushti/et Paraprake ndaj Livrimit për Prokurimin e Produkteve Shëndetësore në Fazën 1 (siç përcaktohet në Nenin 19 të Termave dhe Kushteve Standarde) (Data Përfundimtare siç shprehet në bllokun 7D të Fletës të së Dhënave)

Livrimi nga ana e Fondit Global apo përdorimi nga ana e Përfituesit Kryesor e fondeve të Grantit për të financuar prokurimin e Produkteve Shëndetësore (siç përcaktohet në Nenin 19 të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje) në Fazën 1 është subjekt i kushteve të mëposhtme:

a) Dorëzimi nga ana e Përfituesit Kryesor pranë Fondit Global i një plani për menaxhimin e prokurimit, përdorimit dhe furnizimit të Produkteve Shëndetësore për Programin siç përshkruhet në nënparagrafin (c) të Nenit 19 të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje (Plani MPF); dhe

b) Miratimin me shkrim nga ana e Fondit Global e Planit MPF.

C. TERMA DHE KUSHTE TË VEÇANTA PËR KËTË MARRËVESHJE

Sipas Nenit 12 të Termave dhe Kushteve Standarde të Marrëveshjes Origjinale të titulluar “Taksat dhe Detyrimet”, Përfituesi Kryesor do të sigurojë që janë të krijuar mekanizmat për marrjen e statusit të të përjashtuarit nga taksat për të gjitha mallrat e prokuruar për Programin e Fondit Global.

D. FORMAT QË PËRDOREN PËR KËTË MARRËVESHJE

Për qëllimet e Nenit 15b(i) Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje të titulluar “Raporte Periodike”, Përfituesi Kryesor do të përdorë “Azurnimin e Progresit në Vazhdim dhe Kërkesën për Livrim”, që vihen në dispozicion nga Fondi Global me kërkesë.

E. PLANI I PARASHIKUAR PËR LIVRIMIN

Për qëllimet e Nenit 10.a të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje, plani i parashikuar për livrimin për Programin do të jetë gjashtëmujor duke filluar nga Data e Fillimit të Fazës 2. Datat e sakta për dorëzimin e kërkesave për livrim fondesh janë specifikuar në Kuadrin e Performancës 3&4 bashkëlidhur Aneksit A.

Për qëllimet e Nenit 15b(i) të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje, Programi do të ketë një plan raportimi tremujor me periudha të përcaktuara dhe me datat e sakta për dorëzimin e azhurnimeve të progresit të specifikuara në Kuadrin e Performancës 3&4 bashkëlidhur Aneksit A.

F. BUXHETI I PROGRAMIT

Buxheti bashkëlidhur Aneksit A përcakton shpenzimet e parashikuara për Kohëzgjatjen e Programit (siç përcaktohet në nënparagrafin (a) të Nenit 3 të Termave dhe Kushteve Standarde të kësaj Marrëveshjeje).

TERMA DHE KUSHTE STANDARDE FAQE 1

TERMA DHE KUSHTE STANDARDE

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo është një Marrëveshje ndërmjet Fondit Global të Luftës kundër SIDA-s, Turbekulozit dhe Malariae, një fondacion i krijuar në bazë të ligjeve të Zvicrës (“Fondi Global”), dhe Përfituesit Kryesor të identifikuar në bllokun 2 të fletës së të dhënave të kësaj Marrëveshjeje. Kjo marrëveshje përcakton termat dhe kushtet në bazë të së cilave Fondi Global mund të financojë Përfituesin Kryesor për të zbatuar programin, titulli i të cilit është dhënë në bllokun 3 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje (“Programi”) për vendin e specifikuar në bllokun 1 të kësaj

Marrëveshjeje (“Vendi Përfitues”).

Neni 2 **Zbatimi i programit**

a) Përshkrimi i Programit dhe Objektivat. Përfituesi kryesor do të zbatojë Programin siç përshkruhet në “Përshkrimin e Zbatimit të Programit” të përfshirë në Aneksin A të kësaj Marrëveshjeje. “Struktura/Strukturat e Performancës” bashkëlidhur me Aneksin A të kësaj Marrëveshjeje përcaktojnë objektivat kryesore të Programit, treguesit themelorë, rezultatet e pritshme, synimet dhe periudhat e raportimit të Programit. Për sa kohë nuk tregohet ndryshe, synimet e përcaktuara në Strukturën/Strukturat e Performancës bashkëlidhur Aneksit A të kësaj Marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk përfshijnë vlerat bazë.

b) Buxheti i Programit. “e Buxheti/Buxhetet e Përmbledhura” bashkëlidhur Aneksit A të kësaj Marrëveshjeje përshkruan/përshkruajnë shpenzimet e miratuara për Periudhën e Programit. Përfituesi Kryesor do të zbatojë programin në përputhje me Buxhetin/Buxhetet e Përmbledhura. Ndryshimet në Buxhetin/Buxhetet e Përmbledhura do të bëhen vetëm në zbatim të udhëzimeve me shkrim të nxjerra nga Fondi Global ose nëpërmjet autorizimit me shkrim nga Fondi Global.

Neni 3 **Kohëzgjatja e programit**

a) Faza 1. Përfituesi Kryesor pranon se, që nga data e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes (e përmendur në Nenin 38 të kësaj Marrëveshjeje), Fondi Global do të akordojë fonde për Programin sipas kësaj Marrëveshjeje për një periudhë 24-mujore, e cila fillon në datën e Fillimit të Fazës 1 (e dhënë në bllokun 5 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje) dhe përfundon në Datën e Përfundimit të Fazës 1 (e dhënë në bllokun 6 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje) (në vijim “Kohëzgjatja e Programit”).

b) Faza 2. Fondi Global mund të vendosë, në bazë të diskrecioni të vet, të zgjasë Kohëzgjatjen e Programit tej Datës së Përfundimit të Fazës 1 dhe të akordojë fonde për Fazën 2 të Programit (një “Miratim i Fazës së 2-të”). Nëse Fondi Global bën një Miratim të Fazës së 2-të, atëherë palët do të realizojnë një ndryshim të kësaj Marrëveshjeje dhe “Kohëzgjatja e Programit” do të shtrihet në datën e Përfundimit të Fazës 2 (e dhënë në bllokun 7 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje) apo në çdo datë tjetër të specifikuar nga Fondi Global në Miratimin e tij të Fazës së 2-të.

c) Livrimi i Supozuar i Fondeve. Data e Fillimit të Fazës 1, Data e Përfundimit të Fazës 1 dhe Data e Përfundimit të Fazës 2 do të përcaktohen me anë të datës në të cilën Përfituesi Kryesor merr livrimin e parë të fondeve të Grantit në bazë të kësaj Marrëveshjeje apo siç është rënë dakord ndërmjet palëve. Për këtë qëllim, Përfituesi Kryesor do të konsiderohet se e ka marrë livrimin e parë të fondeve në shtatë ditë kalendarike, pasi Administratori i Fondit Global kryen një transferim telegrafik të një livrimi të tillë për në llogarinë bankare të Përfituesit Kryesor (“Data e Supozuar e Marrjes”). Nëse Data e Supozuar e Marrjes është ndërmjet ditës së parë dhe të katërmëdhjetë të muajit, atëherë Data e Fillimit të Fazës 1 do të jetë dita e parë e atij muaji. Nëse Data e Supozuar e Marrjes është pas ditës së katërmëdhjetë të muajit, atëherë Data e Fillimit të Fazës 1 do të jetë dita e parë e muajit vijues.

d) Njoftimi. Pas Datës së Supozuar të Marrjes, Fondi Global do të njoftojë Përfituesin Kryesor për Datën e Fillimit të Fazës 1, Datën e Përfundimit të Fazës 1 dhe Datën e Përfundimit të Fazës 2 ndërkohë që fleta e të dhënave të kësaj Marrëveshjeje do të azhurnohet respektivisht.

Neni 4 **Fondet e grantit**

Fondi Global i jep në këtë mënyrë Përfutuesit Kryesor një shumë, e cila nuk kalon atë të shprehur në bllokun 8 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje ("Granti") dhe që mund të bëhet e disponueshme për Përfutuesin Kryesor në bazë të termave të kësaj Marrëveshjeje. Përfutuesi Kryesor mund të përdorë vetëm fonde të Grantit për aktivitetet e Programit, të cilat lindin gjatë Kohëzgjatjes së Programit ose vepron sipas mënyrës që përcaktohet me shkrim nga Fondi Global.

Neni 5

Prezantimet dhe garancitë e përfutuesit kryesor

Përfutuesi Kryesor prezanton dhe garanton para Fondit Global në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje sa më poshtë vijon:

a) Kapacitetin Ligjor: Përfutuesi Kryesor është një person juridik që ekziston ligjërisht në përputhje me ligjet e juridiksionit në të cilin është krijuar.

b) Zbatueshmërinë. Kjo Marrëveshje është ekzekutuar në mënyrë të rregullt dhe është dorëzuar nga Përfutuesi Kryesor ndërkohë që është e zbatueshme ndaj Përfutuesit Kryesor në përputhje me termat e saj.

c) Kompetencat e Nevojshme. Përfutuesi Kryesor ka të gjithë kompetencat e nevojshme, autoritetin dhe kapacitetin ligjor për sa vijon: (i) të zotërojë asetet e veta; (ii) të organizojë aktivitetet e Programit; dhe (iii) të nënshkruajë këtë Marrëveshje.

d) Veprimin në përputhje me ligjet. Aktivitetet e Përfutuesit Kryesor kryhen në përputhje me të drejtën e Vendi Përfutues duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e pronësisë intelektuale. Gjithashtu, përfutuesi Kryesor është përgjithësisht i ndërgjegjshëm që ekzistojnë ligje që ndalojnë dhënien e burimeve dhe të mbështetjes për personat dhe organizatat e lidhura me terrorizmin dhe që Bashkimi Evropian, Qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kanë publikuar lista që i identifikojnë individët dhe organizatat të konsideruara si të lidhura me terrorizmin.

e) Mungesën e Pretendimeve. Nuk ekzistojnë pretendime, hetime apo procedime që janë në vazhdim apo të pazgjidhura të cilat, nëse vërtetohet e kundërta, do të kishin një ndikim të kundërt material ndaj kapacitetit të Përfutuesit Kryesor për zbatimin e Programit.

f) Plotësimi. Granti është në plotësim të burimeve që Vendi Përfutues merr nga burimet e jashtme dhe të brendshme për të luftuar sëmundjen e përshkruar në bllokun 9 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje ose, nëse zbatohet, të shpenzimeve shëndetësore (nëse Forcimi i Sistemeve Shëndetësore tregohet në bllokun 9).

g) Mungesën e Mbivendosjes së Financimit: Synimet e vendosura për Programin bëhen të munduara nëpërmjet financimit shtesë të dhënë nga Fondi Global sipas kësaj Marrëveshjeje. Përfutuesi Kryesor nuk përfiton financime nga asnjë burim tjetër që dublikon financimin e dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Marrëveshja e përfutuesit kryesor

Përfutuesi Kryesor bën marrëveshje dhe bie dakord me Fondin Global gjatë Kohëzgjatjes së Programit për sa më poshtë vijon:

a) Autoritet. Personi që nënshkruan dokumentet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje (duke përfshirë çdo ndryshim të kësaj Marrëveshjeje) do të gëzojë, në momentin e një nënshkrimi të tillë, autoritetin për të firmosur dokumente të tilla.

b) Njoftimi për Ngjarjet Materiale. Përfutuesi Kryesor do t'i dërgojë Fondit Global menjëherë njoftim me shkrim për çdo pretendim, hetim apo procedim që, nëse vendoset ndryshe, mund të pritët që, në mënyrë të arsyeshme, të çojë në një efekt të kundërt material ndaj aftësisë së

Përfituesit Kryesor apo të çdo Nën-përfituesi (sipas përshkrimit të dhënë në nenin 14 të kësaj Marrëveshje) lidhur me zbatimin e Programit apo përmbushjen e çdo detyrimi tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Organizimi i Veprimtarisë. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që çdo Nën-përfitues do t'i realizojë të gjitha gjërat e nevojshme për të ruajtur, rinovuar dhe mbajtur në fuqi të plotë ekzistencën e vet ligjore dhe të drejtat, licencat dhe lejet, të cilat mund të kërkojnë për zbatimin e aktiviteteve të Programit për të cilat ata janë përgjegjës.

d) Veprimi në përputhje me ligjet. Përfituesi Kryesor duhet dhe do të sigurojë që çdo Nën-përfitues i tij do të veprojë në përputhje me ligjet e Vendlindjes dhe me ligje të tjera të zbatueshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në pronësinë intelektuale, gjatë realizimit të aktiviteteve të Programit.

e) Plotësimi. Përfituesi Kryesor do të ndërmarrë të gjitha veprimet e disponueshme për të siguruar që paraqitja e bërë në nenin 5 (f) të kësaj Marrëveshje vazhdon të jetë e vlefshme gjatë Kohëzgjatjes së Programit.

f) Njoftimi për Financimin Shtesë. Përfituesi Kryesor do t'i dërgojë njoftim me shkrim Fondit Global për çdo financim shtesë të përfutur nga Përfituesi Kryesor, gjë e cila mund të kërkojë një përshtatje të programit në mënyrë që të përmbushen detyrimet e tij sipas Nenit 5 (g) të kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Mekanizimi i koordinimit

a) MK. Palët pranojnë që Mekanizmi i Koordinimit ("MK") koordinon dorëzimin e propozimeve tek Fondi Global nga Vendi përfitues, duke përfshirë këtu çdo kërkesë për financim në vazhdim të Datës së Përfundimit të Fazës 1 ("Kërkesë për Financim në Vazhdim") dhe monitoron zbatimin e Aktiviteteve të Programit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të programeve të tjera të financuara nga Fondi Global në Vendlindje, nëse ka.

b) Bashkëpunimi. Përfituesi Kryesor do të bashkëpunojë në Mekanizmin e Koordinimit dhe me Fondin Global për të realizuar qëllimin e kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi Kryesor do të jetë i disponueshëm për t'u takuar në mënyrë sistematike me Mekanizmin e Koordinimit për të diskutuar planet, për të bashkëndarë informacionin dhe për të komunikuar për çështje që lidhen me Programin. Përfituesi Kryesor do t'i sigurojë Mekanizmit të Koordinimit, me kërkesën e këtij të fundit, një kopje të raporteve dhe të informacionit material lidhur me Programin për qëllime të informimit. Kjo mund të përfshijë, por nuk është e kufizuar vetëm në, Kërkesat për Livrim Fondesh, zërat e dhënë për të përmbushur një kusht paraprak, letrat e zbatimit dhe çdo ndryshim të kësaj Marrëveshjeje. Gjithashtu, Përfituesi Kryesor do ta ndihmojë Mekanizmin e Koordinimit në përgatitjen e çdo kërkesë për Financim në Vazhdim. Përfituesi Kryesor është i ndërgjegjshëm që Fondi Global mundet, në bazë të diskrecionit të vet, të bashkëndajë informacion me Mekanizmin e Koordinimit rreth Programit.

Neni 8

Agjenti lokal i fondit

a) ALF. Fondi Global ka mbajtur shërbimet e Agjentit Lokal të Fondit ("ALF") siç përcaktohet në bllokun 12 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje për kryerjen e disa veprimeve të caktuara në emër të Fondit Global duke përfshirë sa më poshtë vijon:

i) Vlerësimin e kapacitetit të Përfituesit Kryesor për zbatimin e Programit dhe menaxhimin e fondeve të Grantit; dhe

ii) Verifikimin e progresit të përfituesit Kryesor kundrejt objektivave të Programit, përdorimit të fondeve të Grantit dhe veprimin në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje.

b) Bashkëpunimi. Përfituesi Kryesor duhet dhe do të sigurojë se Nën-përfituesit do të

bashkëpunojnë plotësisht me Agjentin Lokal të Fondit për t'i mundësuar Agjentit Lokal të Fondit përmbushjen e funksioneve. Për këtë qëllim, përfituesi Kryesor do të kryejë, ndër të tjera, sa më poshtë vijon:

- i) Do të dorëzojë tek Fondi Global nëpërmjet Agjentit Lokal të Fondit të gjitha raportet, Kërkesat për Livrim Fondesh dhe komunikimet e tjera që kërkohen sipas kësaj Marrëveshje;
 - ii) Do të dorëzojë tek Agjenti Lokal i Fondit kopje të të gjitha kontrolleve;
 - iii) Do të lejojë Agjentin Lokal të Fondit të kryejë vizita të veçanta në vend sipas momenteve të vendosura nga Agjenti Lokal i Fondit;
 - iv) Do të lejojë Agjentin Lokal të Fondit të shqyrtojë Librat dhe Regjistrat e programit (siç përshkruhet në Nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje) në momentet dhe vendet që vendosen nga Agjenti Lokal i Fondit;
 - v) Do të lejojë Agjentin Lokal të Fondit t'i bëjë pyetje personelit të tij dhe personelit të Nën-përfituesve;
 - vi) Do të bashkëpunojë me Agjentin Lokal të Fondit për të identifikuar kualifikimin shtesë dhe rritjen e kapaciteteve që mund t'i nevojiten Përfituesit Kryesor dhe Nën-përfituesve për të zbatuar Programin; dhe
 - vii) Do të bashkëpunojë me Agjentin Lokal të Fondit në mënyra të tjera që mund t'i specifikojë Fondi Global.
- c) Përfaqësuesi i Agjentit Lokal të Fondit. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përfaqësuesi kryesor i Agjentit Lokal të Fondit do të jetë personi i emëruar apo që vepron sipas pozicionit të identifikuar në bllokun 12 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje. Fondi Global mundet, në bazë të diskrecionit të vet, të marrë vendim të zëvendësojë Agjentin Lokal të Fondit ose të emërojë një përfaqësues alternativ kryesor të Agjentit Lokal të Fondit dhe të informojë përkatësisht Përfituesin Kryesor.

Neni 9

Menaxhimi i fondeve të grantit

Përfituesi Kryesor do të sigurojë që të gjitha fondet Grantit menaxhohen me maturi dhe do të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që fondet e Grantit përdoren vetëm për qëllimet e Programit dhe në pajtueshmëri me termat e kësaj Marrëveshjeje. Prandaj, përfituesi Kryesor do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar që fondet e Grantit nuk përdoren as nga ai dhe as nga ndonjëri prej Nën-përfituesve të tij për të mbështetur apo promovuar dhunën, për të ndihmuar terroristë apo aktivitetet e lidhura me terrorizmin, për të kryer aktivitete të pastrimit të parave apo për të financuar organizata që dihet se mbështesin terrorizmin apo që janë të përfshira në aktivitete të pastrimit të parave.

Neni 10

Livrimi i fondeve të grantit

a) Livrimet e fondeve. Pavarësisht nga grafiku i livrimit që jepet në Aneksin A të kësaj Marrëveshjeje, afati dhe shuma e çdo livrimi të fondeve të grantit do të përcaktohet nga Fondi Global në bazë të diskrecionit të vet. Fondi Global nuk do të bëjë asnjë livrim të fondeve të Grantit në rast se:

- i) Përfituesi Kryesor nuk ka dorëzuar pranë Fondit Global një Kërkesë për Livrim Fondesh të firmosur nga personi apo personat e autorizuar nga Përfituesi Kryesor për të vepruar në këtë mënyrë, me formë dhe përmbajtje të përshtatshme për Fondin Global dhe në një kohë të pranueshme për Fondin Global;
- ii) Fondi Global ka përcaktuar në bazë të diskrecionit të vet që fondet e mjaftueshme për të bërë një livrim nuk janë të disponueshme për Fondin Global për një qëllim të tillë në momentin e livrimit;

iii) Përfituesi Kryesor nuk ka përmbushur, në formë dhe përmbajtje të përshtatshme për Fondin Global, kushtet paraprake për një livrim të tillë apo kushtet e veçanta të përshkruara në Aneksin A, nëse ka, dhe brenda datës përfundimtare të treguar në fletën e të dhënave të kësaj marrëveshje apo afatet e tjera të shënuara në kushtet e veçanta;

iv) Përfituesi Kryesor nuk demonstroi se shuma e kërkuar në Kërkesën e tij për Livrim Fondesh është bazuar në nevojat e tij të arsyeshme për qarkullim monetar gjatë periudhës për të cilën është kërkuar livrimi i fondeve;

v) Përfituesi Kryesor nuk i ka përcjellë Fondit Global të gjitha Raportet Programatike të Progresit të përmendura në Nenin 15 (b) të kësaj Marrëveshjeje që duhej të ishin përcjellë përpara datës së Kërkesës për Livrim Fondesh;

vi) Përfituesi Kryesor nuk demonstroi se ai ka arritur rezultate programatike në pajtueshmëri me synimet për treguesit e përcaktuar në Strukturën/Strukturat e Performancës bashkëlidhur Aneksit A të kësaj Marrëveshjeje gjatë periudhave të përcaktuara aty dhe nuk shpjegon arsyet e devijimit nga synimet;

vii) Pas marrjes së Produkteve Shëndetësore në vend, të blera me anë të përdorimit të fondeve të Grantit, Përfituesi Kryesor nuk ka raportuar çmimet dhe të dhënat e tjera të lidhura me furnizimin, që duhen raportuar tek Fondi Global në përputhje me nenin 19 (t) të kësaj Marrëveshjeje duke përdorur Mekanizmin e Raportimit të Çmimeve që është i disponueshëm në faqen e internetit të Fondit Global apo të mjeteve të tjera të përshtatshme që Fondi Global mund të vërë në dispozicion për këtë qëllim; dhe

viii) Agjenti Lokal i Fondit (i përmendur në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje) nuk verifikon informacionin e dhënë në kuadër të kërkesës për Livrim Fondesh.

b) Afatet. Nëse kushtet paraprake apo kushtet e veçanta të treguara në Përshkrimin e Zbatimit të Programit nuk janë përmbushur brenda datës apo afatit përfundimtar, ose nëse përfituesi Kryesor nuk arrin të realizojë synimet programatike e përcaktuara në këtë marrëveshje, gjatë periudhës së parashikuar aty, atëherë Fondi Global mundet, në çdo kohë, dhe në bazë të diskrecionit të vet, të përfundojë apo të pezullojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Përfituesit Kryesor sipas nenin 26 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Data e Përfundimit të Fazës 1. Fondi Global nuk do të autorizojë livrimin e asnjë fondi të Grantit pas Datës së Përfundimit të Fazës 1, në rast se palët nuk ndryshojnë këtë Marrëveshje për të pasqyruar një Miratim të Fazës 2 (siç përshkruhet në Nenin 3 (b) të kësaj Marrëveshjeje).

Neni 11

Llogaritë bankare, interesat dhe të ardhura të tjera të programit

a) Llogaria Bankare. Përfituesi Kryesor do të sigurojë se:

i) Fondet e Grantit nën zotërimin e Përfituesit Kryesor apo të Nën-përfituesve qëndrojnë, në atë masë që është praktike, në një llogari bankare e cila mban një interes në një normë të pranueshme tregtare që është i disponueshëm në Vendlin Përfitues derisa ato të shpenzohen për qëllimet e Programit;

ii) Fondet e Grantit janë depozituar në një bankë që është në përputhje të plotë me të gjitha standardet dhe rregullat e zbatueshme vendase dhe ndërkombëtare bankare duke përfshirë kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit; dhe

iii) Në çdo moment, fondet e Grantit mbahen në para fizike dhe mund të tërhiqen në çdo kohë, tërësisht, sipas kërkesës.

b) Interesi. Çdo interes mbi fondet e Grantit të livruara nga Fondi Global për përfituesin Kryesor sipas kësaj Marrëveshjeje apo nga Përfituesi Kryesor për Nën-përfituesit do të llogaritet dhe përdoret vetëm për qëllimet e Programit.

c) Të ardhurat. Çdo e ardhur e fituar nga Përfituesi Kryesor apo nga nën-përfituesit nga aktivitetet e Programit, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në të ardhurat e përfituara nëpërmjet aktiviteve të “marketimit social”, do të llogariten dhe përdoren vetëm për qëllimet e

Programit.

Neni 12 Taksat dhe detyrimet

a) Përjashtimi nga Taksat. Përfituesi Kryesor nxitet fuqimisht që të sigurojë se kjo Marrëveshje dhe blerja e çdo malli apo shërbimi nëpërmjet përdorimit të fondeve të Grantit nga ana e përfituesit Kryesor dhe e çdo Nen-përfituesi do të jenë të përjashtuara nga taksat dhe detyrimet e vendosura në bazë të ligjit në Vendin Përfitues. Përfituesi Kryesor do të informojë, brenda 90 ditëve pas Datës së Fillimit të Fazës 1, Fondin Global për gjendjen e përjashtimit nga taksat dhe detyrimet që janë bërë për ndihmën në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

b) Rimbursimi i taksave. Nëse një taksë apo detyrim është vënë dhe është paguar nga Përfituesi Kryesor apo Nen-përfituesi, pavarësisht përjashtimit nga një taksë apo detyrim i tillë, atëherë Fondi Global mund, në bazë të diskrecionit të vet, (i) t'i kërkojë Përfituesit Kryesor që të rimbursojë Fondin Global ose të tjerët pasi Fondi Global mund ta rregullojë shumën e një takse të tillë me fonde të tjera të ndryshme nga ato që janë dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje; ose (ii) të kompensojë shumën e një takse të tillë nga shumat që do të livrohen në bazë të kësaj apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet Fondit Global dhe Përfituesit Kryesor.

c) Zgjidhja e Problemeve me Taksat. Në rast mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e përjashtimit nga taksat dhe detyrimet që është bërë nga Qeveria e Vendit Përfitues, Fondi Global dhe përfituesi Kryesor do të përpiqen menjëherë që të zgjidhin probleme të tilla të udhëhequr nga parimi që fondet e llojit Grant synohet të jenë të përjashtuara nga taksimi me qëllim që të gjitha fondet Grant të dhëna nga Fondi Global të kontribuojnë drejtpërsëdrejti në trajtimin dhe parandalimin e sëmundjeve në Vendin Përfitues.

Neni 13 Kontrollet dhe dokumentet kontabël

a) Librat e Llogarive dhe Dokumentet Kontabël të Përfituesit Kryesor. Përfituesi Kryesor duhet dhe do të sigurojë që Nen-përfituesit do të mirëmbajnë librat e kontabilitetit, evidencat kontabël, dokumentet dhe çdo evidencë tjetër që lidhet me këtë marrëveshje, që janë të sakta për të treguar, pa kufizim, të gjitha kostot e shkaktuara dhe të ardhurat e fituara nga Përfituesit Kryesor për Programin dhe për progresin tërësor në drejtim të realizimit të Programit ("Librat dhe Dokumentet Kontabël të Programit"). Përfituesi Kryesor dhe Nen-përfituesit do të mbajnë Librat e Llogarive dhe Dokumentet Kontabël në pajtim me standardet e kontabilitetit përgjithësisht të pranuar në Vendin Përfitues. Librat e Llogarive dhe Dokumentet Kontabël të Programit duhet të mbahen nën zotërimin e Përfituesit Kryesor për të paktën tre vite pas datës së livrimit të fundit të fondit/fondeve në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ose për një periudhë të tillë më të gjatë, nëse ka një të tillë, që kërkohet për të zgjidhur ndonjë pretendim apo hetim të kontrollit, ose nëse një gjë të tillë e kërkon Fondi Global.

b) Kontrollet ndaj përfituesit Kryesor. Përfituesi Kryesor do t'i nënshtrohet kontrolleve financiare vjetore të së ardhurave dhe shpenzimeve të Programit, kontrolle të cilat kryhen nga një kontrollor i pavarur. Periudha e parë që i nënshtrohet kontrollit do të jetë viti i parë i plotësuar fiskal i Përfituesit Kryesor (siç tregohet në Bllokun 11 të fletës së të dhënave të kësaj Marrëveshjeje). Megjithatë, nëse mbyllja e një viti të parë të tillë fiskal është me e shkurtër se gjashtë muaj pas Datës së Fillimit të Fazës 1, periudha e parë që i nënshtrohet kontrollit do të jetë ajo që nis nga Data e Fillimit të Fazës 1 e që vazhdon deri në fund të një viti të tillë fiskal.

c) Kontrollori i Pavarur. Jo më vonë se tre muaj pas Datës së Fillimit të Fazës 1, Përfituesi Kryesor duhet të njoftojë Fondin Global për kontrollorin e pavarur që ai ka zgjedhur për të kryer kontrollet vjetore të përmendura në paragrafin (b) të këtij Neni. Zgjedhja përfundimtare e kontrollorit të pavarur dhe e termave të referencës së tij do t'i nënshtrohen

miratimit të Fondit Global dhe do të realizohet jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Fillimit të Fazës 1.

d) Kontrollat ndaj Nën-përfituesve. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që do të realizohen kontrollat vjetore të së ardhurave dhe shpenzimeve të çdo Nën-përfituesi të fondeve të Grantit. Në lidhje me këtë kërkesë, Përfituesi Kryesor do të dorëzojë pranë Fondit Global një plan për kontrollat të tilla ndaj Nën-përfituesve jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Fillimit të Fazës 1 dhe një kopje të së gjitha kontrolleve të plotësuara ndaj Nën-përfituesve. Periudha e parë e Nën-përfituesve që i nënshtrohet kontrollit nuk do të jetë më vonë se periudha e parë e kontrollit e zbatueshme në bazë të nënparagrafit (b) më sipër.

e) Raportet e Kontrollorëve. Përfituesi Kryesor do t'i sigurojë Fondit Global një raport kontrolli për çdo kontroll të përgatitur nga përfituesi Kryesor apo Nën-përfituesit në përputhje me këtë nën jo më vonë se gjashtë muaj pas periudhës nën kontroll.

f) Kontrolli nga Fondi Global. Fondi Global rezervon të drejtën, vetë apo nëpërmjet një agjenti (nëpërmjet përdorimit të fondeve të Grantit apo burimeve të tjera të disponueshme për këtë qëllim) të kryejë kontrollin e kërkuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe/ose të organizojë një shqyrtim financiar, kontroll ose vlerësim rrethanor, ose të ndërmarrë çdo veprim tjetër që e shikon të arsyeshme për të siguruar përgjegjshmërinë e Përfituesit Kryesor dhe të Nën-përfituesve për fondet e Granteve dhe për të mbikëqyrur sjelljen në përputhje me ligjet të Përfituesit Kryesor me termat e kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi Kryesor duhet dhe do të sigurojë që Nën-përfituesit të bashkëpunojnë me Fondin Global dhe agjentët e tij në organizimin e një shqyrtimi të tillë, kontrolli, vlerësimi apo veprimi tjetër.

g) E Drejta e Aksesit. Përfituesi Kryesor do të lejojë ose do t'i sigurojë përfaqësuesve të autorizuar të Fondit Global, agjentëve të tij apo çdo palë tjetër të tretë të autorizuar nga Fondi Global akses në çdo kohë në: (i) Librat e Llogarive dhe Dokumentet Kontabël të Programit apo në çdo lloj tjetër dokumentacion që ka të bëjë me Programin dhe që mbahet nga Përfituesi Kryesor; (ii) ambientet e Përfituesit Kryesor apo të çdo Nën-përfituesi ku mbahen Librat e Llogarive dhe Dokumentet Kontabël të Programit apo ku realizohen aktivitetet e Programit; (iii) vende të tjera ku mbahet dokumentacioni i lidhur me Programin apo ku realizohen aktivitetet e Programit; dhe (iv) ndaj të gjithë personelit të Përfituesit Kryesor dhe/ose Nën-përfituesve të fondeve të Grantit. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që marrëveshjet e tij me Nën-përfituesit përfshijnë të drejtën e aksesit të Fondit Global sipas këtij nën-paragrafi.

h) Njoftimi. Përfituesi Kryesor do të njoftojë menjëherë me shkrim Fondin Global për çdo kontroll apo hetim ligjor që i përket veprimeve të Përfituesit Kryesor apo një Nën-përfituesi.

Neni 14 Nën-përfituesit

Herë pas here, Përfituesi Kryesor mund t'u sigurojë, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, fonde Granti subjekteve të tjera ose të bëjë pagesa direkte për palët e treta në emër të subjekteve të tjera për realizimin e aktiviteteve të Programit ("Nën-përfituesit"), me kusht që Përfituesi Kryesor:

a) Vlerëson kapacitetin e çdo Nën-përfituesi për zbatimin e aktiviteteve të Programit dhe raportin pas kësaj, vë vlerësime të tilla në dispozicion të Fondit Global sipas kërkesës, dhe zgjedh çdo Nën-përfitues në bazë të një vlerësimi pozitiv të kapacitetit të atij nën-përfituesi për të realizuar aktivitetet e Programit që i caktohen atij dhe, në një mënyrë transparente të dokumentuar;

b) Hyn në një marrëveshje granti me secilin prej Nën-përfituesve duke krijuar detyrime të Nën-përfituesit ndaj Përfituesit Kryesor që janë përgjithësisht të barasvlershme me ato të Përfituesit Kryesor sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që krijohen për të lehtësuar veprimin e Përfituesit Kryesor në përputhje me termat e kësaj Marrëveshjeje. Detyrime të tilla do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen vetëm në, një kërkesë që Nën-përfituesi t'i përdorë të gjitha fondet e Grantit

vetëm për qëllimet e Programit dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që fondet e Grantit nuk përdoren për të mbështetur apo promovuar dhunën, për të ndihmuar terroristë apo aktivitetet e lidhura me terrorizmin, për të kryer aktivitetet e pastrimit të parave apo për të financuar organizata që dihet se mbështesin terrorizmin apo që janë të përfshira në aktivitetet e pastrimit të parave;

c) Vë në dispozicion të Fondit Global, me kërkesë të këtij të fundit, një kopje të çdo marrëveshjeje Granti me nën-përfituesin; dhe,

d) Mban dhe vepron në përputhje me një sistem për të mbikëqyrur performancën e Nën-përfituesve dhe siguron raportim të rregullt prej tyre në përputhje me këtë Marrëveshje.

Përfituesi Kryesor pranon dhe bie dakord që dhënia e fondeve të Grantit për Nën-përfituesit ose bërja e pagesave në emër të Nën-përfituesve për të zbatuar aktivitetet e Programit nuk e liron Përfituesin Kryesor nga detyrimet dhe përgjegjësitë e tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi Kryesor është përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e Nën-përfituesit të tij në lidhje me Programin sikur ato të ishin veprimet dhe mosveprimet e Përfituesit Kryesor.

Neni 15

Raportet programatike të progresit

a) Dorëzimi i Raporteve. Përfituesi Kryesor do t'i dorëzojë Fondit Global raportet e specifikuar në paragrafin (b) të këtij Neni. Gjithashtu, Përfituesi Kryesor do t'i sigurojë Fondit Global informacione dhe raporte të tjera të tilla në momente të tilla që Fondi Global mund t'i kërkojë. Herë pas here, Fondi Global mund t'i sigurojë Përfituesit Kryesor udhëzime nëpërmjet botimeve në faqen e internetit të Fondit Global apo nëpërmjet letrave të zbatimit mbi shpëstësinë, formën dhe përmbajtjen e pranueshme të raporteve që kërkojnë në bazë të këtij Neni. Përfituesi Kryesor do t'i sigurojë Mekanizmit të Koordinimit një kopje të të gjitha raporteve që përfituesi Kryesor i dorëzon Fondit Global sipas këtij Neni.

b) Raportet që kërkojnë:

i) Raportet Periodike. Përfituesi Kryesor do të raportojë, jo më vonë se 45 ditë pas mbylljes së çdo periudhe të raportimit që tregohet në Aneksin A të kësaj Marrëveshjeje, mbi progresin në drejtim të objektivave dhe synimeve të Programit për atë periudhë që tregohet në Aneksin A. Përfituesi Kryesor do të dorëzojë raporte periodike mbi formën e specifikuar në Aneksin A. Për periudhën në fjalë, Përfituesi Kryesor do të shpjegojë në raport çdo ndryshim ndërmjet arritjeve të planifikuara dhe atyre faktike dhe ndërmjet shpenzimeve të planifikuara dhe atyre faktike.

ii) Raportet Vjetore të Progresit. Jo më vonë se 18 muaj pas Datës së Fillimit të Fazës 1 dhe çdo vit pas kësaj, Përfituesi Kryesor do të dorëzojë pranë Fondit Global, sipas formës dhe përmbajtjes së përshtatshme për Fondin Global, Raportin Vjetor të Progresit që mbulon progresin programatik gjatë vitit paraardhës programatik apo fiskal të Përfituesit Kryesor. Udhëzimet për formën e këtij raporti vihen në dispozicion në bazë të kërkesës nga Fondi Global.

c) Përdorimi i Raporteve. Përfituesi Kryesor pranon dhe bie dakord që Fondi Global mund të bëjë publik pjesë ose të gjithë raportin e që dorëzohet nga Përfituesi Kryesor pranë Fondit Global në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi Kryesor pranon dhe bie dakord gjithashtu se Fondi Global mund të përdorë, riprodhojë, të modifikojë dhe/ose të përshtatë informacionin dhe të dhënat e tjera që i përmbajnë raporte të tilla për çfarëdolloj arsye.

Neni 16

Monitorimi dhe vlerësimi

Përfituesi Kryesor do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e Programit drejt objektivit të tij, duke përfshirë aktivitetet e zbatuara nga Nën-përfituesit, në përputhje me planin e monitorimit dhe të vlerësimit të miratuar nga Fondi Global. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që ai merr të

dhëna cilësore lidhur me një progres të tillë dhe raporton me saktësi mbi rezultatet e Programit.

Neni 17

Vlerësimet nga fondi global

Fondi Global mund të organizojë apo të autorizojë, në bazë të diskrecionit të vet, vlerësime të Programit apo të aktiviteteve të specifikuar të Programit, të strukturave zbatuese apo të çështjeve të tjera të Programit. Fondi Global do të specifikojë termat e referencës për çdo vlerësim dhe një programim të përshtatshëm për realizimin e tij. Përfituesi Kryesor duhet dhe do t'i kërkojë Nën-përfituesve që të lehtësojnë vlerësimin. Ushtrimi i kësaj të drejte nga ana e Fondit Global nuk zbut detyrimin e Përfituesit Kryesor për të monitoruar dhe vlerësuar Programin.

Neni 18

Kontratat për mallrat dhe shërbimet

a) Praktikantët e Prokurimit. Përfituesi Kryesor do ta mbajë Fondin Global vazhdimisht të informuar rreth politikave dhe praktikave që ai do të përdorë për të kontraktuar mallra dhe shërbime sipas kësaj Marrëveshjeje. Minimalisht, politikantët dhe praktikantët që drejtojnë të gjithë prokurimin sipas Programit do të përputhen me kërkesat e parashikuara nga nënparagrafi (i) deri tek nënparagrafi (viii) të renditur më poshtë, në të cilën prokurorin Produktet Shëndetësore, si dhe me kërkesat e nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që politika dhe praktika të tilla ndiqen në çdo kohë.

i) Kontratat do të jepen mbi baza transparente dhe konkurruese duke iu nënshtruar vetëm përjashtimeve të përcaktuara të përfshira në politikantët dhe praktikantët e shkruara që i janë dhënë Fondit Global.

ii) Të gjitha ftesat për oferta kontratash duhet t'i njoftohen në mënyrë të qartë të gjithë ofertuesve të ardhshëm, të cilëve do t'u jepet një periudhë e mjaftueshme kohe për t'u përgjigjur një kërkesë të tillë.

iii) Ftesat për mallra dhe shërbime do të sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për një ofertues të ardhshëm në mënyrë që të përgatisë një ofertë dhe, prandaj, do të mbështetet mbi një përshkrim të qartë dhe të saktë të termave dhe kushteve të propozuara të kontratës dhe të mallrave apo të shërbimeve që kërkohen.

iv) Kushtet e pjesëmarrjes në një ofertë kontrate do të kufizohen në ato që janë kryesore për të siguruar aftësinë e pjesëmarrësve për realizimin e kontratës në fjalë dhe veprimin në përputhje me ligjet e brendshme të prokurimit.

v) Kontratat do t'u jepen vetëm kontraktuesve të përgjegjshëm që zotërojnë aftësinë për të përmbushur me sukses kontratat.

vi) Për të marrë mallrat dhe shërbimet nuk do të paguhet asgjë më shumë se sa një çmim i arsyeshëm (siç përcaktohet, për shembull, nëpërmjet krahasimit të kuotimeve të çmimit dhe çmimeve të tregut).

vii) Përfituesi Kryesor, përfaqësuesit e tij dhe agjentët nuk do të angazhohen në asnjë nga praktikantët e përshkruara në Nenin 21(b) në lidhje me një prokurim të tillë.

viii) Përfituesi Kryesor do të mbajë regjistrimet duke dokumentuar në detaje marrjen dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të përfituara në bazë të Marrëveshjes nga ana e Përfituesit Kryesor, natyrën dhe shkallën e kërkesave të furnizuesve të ardhshëm të mallrave dhe shërbimeve të marra nga Përfituesi Kryesor, dhe bazën e dhënies së kontratave dhe porosive të Përfituesit Kryesor.

b) Zinxhiri i Furnizimit. Përfituesi Kryesor do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar besueshmërinë, efikasitetin dhe sigurinë optimale në lidhje me zinxhirin e furnizimit për të gjitha produktet e blera me fondet e Grantit.

c) Veprimi i Nën-përfituesve në Përputhje me Rregullat. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që Nën-përfituesit të veprojnë në përputhje me kërkesat e këtij Neni kur Nën-përfituesit

ndërmarrin prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve për Programin.

d) Dokumentet Kontabël. Përfituesi Kryesor duhet, dhe do të sigurojë që Nën-përfituesit mbajnë dokumente kontabël të përshtatshme për të gjitha asetet fikse të blera me fondet e Grantit.

e) Titulli. Titulli mbi mallrat apo pasurinë e financuar nga Fondi Global në bazë të kësaj Marrëveshjeje (“Asetet e Programit”) do të mbahen nga Përfituesi Kryesor ose nga Nën-përfituesi apo një subjekt tjetër i miratuar nga përfituesi Kryesor, në rast se Fondi Global nuk vendos, në çdo kohë bazuar në diskrecionin e vet, që titulli t’i transferohet Fondit Global apo një subjekti tjetër të caktuar nga Fondi Global.

f) Qëllimet e Programit. Përfituesi Kryesor do të sigurojë, në përputhje me Nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje, se të gjitha mallrat, shërbimet dhe aktivitetet e financuara me fondet e Grantit, duke përfshirë ato të prokuruar dhe të zbatuara nga Nën-përfituesit, përdoren vetëm për qëllimet e programit.

Neni 19

Barnat dhe produktet e tjera shëndetësore

a) Përkufizime. Termit e mëposhtëm të përdorur në këtë Nen kanë kuptimin e dhënë si më poshtë vijon:

“OBSh” është Organizata Botërore e Shëndetësisë

Termit “ilaçe”, “produkt farmaceutik shumëburimësh” dhe “produkte farmaceutike” kanë kuptimin e përdorur nga OBSh-ja në “Fjalorin” e saj të “Autorizimit të Marketingut të Produkteve Farmaceutike me referencë të Veçante ndaj Produkteve Shumëburimëshe (Të përgjithshme): Manual për Autoritetet Rregullatore të Barnave.”

Termi “Produkte Shëndetësore” përfshin (i) produktet farmaceutike dhe (ii) produktet shëndetësore diagnostike dhe jo-farmaceutike.

Termi “produktet shëndetësore diagnostike dhe jo-farmaceutike” përfshin, (i) produkte shëndetësore afatgjata (ii) produkte shëndetësore të konsumueshme/njëpërdorimëshe.

Termi “produkte shëndetësore afatgjata” përfshin, por nuk është i kufizuar vetëm në, makineritë e analizave të ngadalta të virusit HIV, makineri të monitorimit të virusit HIV (CD4s, Ngarkesë Virale), susta krevatesh, pajisje laboratorike, pajisje radiologjie dhe produkte mbështetëse (p.sh., mikroskopë dhe reagentë).

Termi “produkte shëndetësore të konsumueshme/njëpërdorimëshe” përfshin, por nuk është i kufizuar vetëm në, prezervativët, analizat (e shpejta dhe të ngadalta) të anti-trupave HIV, testet e shpejta të malarisë, insekticidet, spërkatësit ajrorë kundër mushkonjave, biberonë dhe shiringa injeksioni.

Termi “kompetencë e rrepte rregullatore” do të thotë kompetencën rregullatore të një (a) anëtarit të Konventës së Inspektimit Farmaceutik ose të një subjekti pjesëmarrës në Skemën e Bashkëpunimit të Inspektimit Farmaceutik (SBIF); ose (b) të një anëtarit të Konferencës Ndërkombëtare për Harmonizimin e Kërkesave Teknike të Regjistrimit të Barnave për Përdorim Njerëzor (KNH).

Termi “Programi i Parakualifikimit të OBSh-së” do të thotë Programi i Parakualifikimit i Kombeve të Bashkuara i menaxhuar nga OBSh-ja, i cili synon të lehtësojë aksesin ndaj ilaçeve që plotësojnë standardet e unifikuara të cilësisë, sigurisë dhe të efektshmërisë për HIV/SIDA-n, malarinë dhe tuberkulozin.

Termi “PMP” do të thotë Praktikë e Mirë Prodhimi dhe si i tillë përdoret nga OBSh-ja në “Autorizimin e Marketingut të Produkteve Farmaceutike me referencë të Veçantë ndaj Produkteve Shumëburimëshe (Të përgjithshme): Manual për Autoritetet Rregullatore të Barnave”.

Për sa i përket Vendit Përfitues, termi “Autoritet Kombëtar Rregullator i Barnave” do të thotë autoriteti rregullator kombëtar i barnave i njohur në një Vend të tillë Pritës.

Për sa i përket nënparagrafit (j) të këtij Neni, produkti është “i disponueshëm” kur

prodhuesi i tij nuk është në gjendje të furnizojë një sasi të mjaftueshme të produktit të përfunduar brenda 90 ditësh nga data e porositjes.

b) Veprimi në përputhje me rregullat. Kur një Nën-përfitues kryen prokurim të një Produkti Shëndetësor, atëherë përfituesi Kryesor do të sigurojë që një prokurim i tillë kryhet në përputhje me këtë Nen. Në të gjitha rastet, produktet farmaceutike dhe produktet e konsumueshme/njëpërdorimëshe të financuara me fondet e Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje do të plotësojnë standardet cilësore të cilësisë të përcaktuara herë pas here nga Fondi Global.

c) Vlerësimi i Prokurimit dhe Plani MPF. Si pasojë e kompleksitetit dhe e risqeve të rëndësishme të prokurimit të Produkteve Shëndetësore, asnjë fond i Grantit nuk mund të përdoret për të financuar një prokurim të tillë derisa:

i) Përfituesi Kryesorë të ketë dorëzuar pranë Fondit Global, sipas formës dhe përmbajtjes së përshtatshme me kërkesat e Fondit Global, një plan për menaxhimin e prokurimit, të përdorimit dhe të furnizimit të Produkteve Shëndetësore që do të prokurohen, i cili është në përputhje me këtë Nen ("Plani MPF"). Plani MPF do të përmbajë një plan për të prokuruar dhe për të përdorur teknologjitë dhe mjetet diagnostike dhe kategori të tjera të rëndësishme të furnizimeve lidhur me sigurimin e ilaçeve; dhe

ii) Fondi Global ka miratuar Planin MPF dhe ka marrë një vlerësim pozitiv të aftësisë së Përfituesit Kryesor për menaxhimin e një prokurimi të tillë.

Fondi Global do ta këshillojë Përfituesin Kryesor me shkrim kur ai të ketë miratuar Planin MPF. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që prokurimi sipas një Programi të tillë realizohet në përputhje me Planin MPF.

d) Lista e ilaçeve që do të prokurohen. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që fondet e Grantit nuk përdoren për të prokuruar ilaçe që nuk ekzistojnë në udhëzimet aktuale të trajtimit standard apo në listat e ilaçeve kryesore të OBSH-së, të qeverisë së Vendi Përfitues, apo Përfituesit Kryesor ose të Nën-përfituesit. Plani MPF do të përfshijë një listë të udhëzimeve të trajtimit standard dhe lista të ilaçeve kryesore që do të zbatohen ndaj Programit.

e) Përgjegjësitë e Prokurimit. Në rrethanat kur Fondi Global ka përcaktuar që Përfituesi Kryesor zotëron kapacitetin e kërkuar për prokurimin, atëherë Përfituesi Kryesor do të jetë përgjegjës për të gjithë prokurimin në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe, mbështetur në diskrecionin e tij, mund të përdorë apo të lejojë Nën-përfituesit e tij të përdorin agjentë prokurimi të kontraktuar në nivel lokal, rajonal apo ndërkombëtar për të realizuar prokurime. Nëse Fondi Global nuk ka përcaktuar që Përfituesi Kryesor zotëron kapacitetin e kërkuar për prokurimin, atëherë Përfituesi Kryesor do të përdorë agjentët e përcaktuar rajonal apo ndërkombëtarë ose mekanizma të tjerë të pranueshëm për Fondin Global, por do të mbetet përgjegjës për pajtueshmërinë e të gjithë prokurimit me termat e Nenit.

Në të gjitha rastet përfituesi Kryesor inkurajohet të përdorë apo t'i bëjë Nën-përfituesit të përdorin shërbime të afta rajonale dhe globale kurdoherë që grumbullimi i kërkesës ul çmimet për produktet e cilësisë së garantuar.

f) Praktikë e Prokurimit. Përfituesi Kryesor do të sigurojë që prokurimi i produkteve farmaceutike sipas kësaj Marrëveshjeje i përmbahet Parimeve Operacionale Ndër-Agjenci për Prokurimin e Mirë, me përjashtim të rasteve kur praktikë ekzistuese ndryshojnë nga Udhëzimet Ndër-Agjenci: Parime Operacionale për Prokurim të Mirë Farmaceutik. Përfituesi Kryesor demonstron, në formë dhe përmbajtje të përshtatshme për rregullat e Fondit Global, një sistem krahasues të prokurimit konkurrues nga një grup furnizuesish të para-kualifikuar, transparencë dhe përgjegjshmëri të praktikave të tyre dhe zbatimin e mekanizmave të garantimit të cilësisë së kërkuar.

g) Çmimi më i ulët i mundshëm. Përfituesi Kryesor do të përdorë praktikë e mira të prokurimit gjatë prokurimit të Produkteve Shëndetësore, duke përfshirë blerjen konkurruese nga prodhuesit dhe furnizuesit e kualifikuar (dhe, në veçanti, në lidhje me produktet farmaceutike, në pajtueshmëri me nënparagrafin (f) më sipër) për të marrë çmimin më të ulët të produkteve, në përputhje me garantimin e cilësisë. Për sa i përket produkteve afatgjata shumëpërdorimëshe,

çmimi më i ulët i mundshëm do të marrë parasysh koston totale të pronësimit, duke përfshirë koston e reagentëve dhe të elementeve të tjerë të konsumueshëm si dhe kostot e mirëmbajtjes vjetore.

h) Pajtueshmëria me standardet e cilësisë. Produktet Shëndetësore mund të financohen me fondet e Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse sigurohen standardet e cilësisë së produkteve të tilla farmaceutike. Produktet e konsumueshme/njëpërdorimshme mund të financohen e fondet e Grantit sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse produktet e tilla zgjidhen nga lista e produkteve të para-kualifikuara, kur ato ekzistojnë, ose nëse produkte të tilla pranohen nga autoritetet rregullatore rigoroze apo pranohen nga standardet kombëtare.

i) Produktet Farmaceutike Shumëburimëshe. Për produktet farmaceutike shumëburimëshe (domethënë, produkte farmaceutike për të cilat monografi i formës së dozës së përfunduar është botuar në Farmakopenë Ndërkombëtare, në atë të Shteteve të Bashkuara apo të Mbretërisë së Bashkuar përpara datës 10 Tetor 2002), Përfituesi Kryesor mund të verifikojë pajtueshmërinë me standardet e zbatueshme në përputhje me procedurat kombëtare ekzistuese të Vendit Përfitues.

j) Produktet me Burim të Vetëm apo me Burim të Kufizuar dhe Produkte të Tjera Farmaceutike. Fondet e Grantit mund të përdoren për të prokuruar një produkt farmaceutik me burim të vetëm apo me burim të kufizuar (domethënë, një produkt farmaceutik për të cilin nuk ekzistojnë standarde cilësie publikisht të disponueshme, metoda analitike dhe standarde reference) dhe/ose një produkt farmaceutik për të cilin monografi i formës së dozës së përfunduar është botuar në Farmakopenë Ndërkombëtare, në atë të Shteteve të Bashkuara apo të Mbretërisë së Bashkuar me ose pas datës 10 Tetor 2002, me kusht që një produkt i tillë plotëson një nga standardet e mëposhtme:

a) Një produkt i tillë është i pranueshëm sipas Programit të Parakualifikimit të OBSH-së; ose

b) Një produkt i tillë është autorizuar nga një autoritet kompetent rregullator.

Nëse Përfituesi Kryesor përcakton se ekziston një ose asnjë produkt farmaceutik ekuivalent që plotëson standardet e pikës (1) ose (2) të nënparagrafit (j) të këtij Neni, ose nëse Përfituesi Kryesor përcakton se produktet që përmbushin këto standarde nuk janë të disponueshme dhe paraqesin të njëjtën gjë përpara Fondit Global dhe, Fondi Global nuk kundërshton, atëherë fondet e Grantit mund të përdoren për të prokuruar një tjetër produkt farmaceutik ekuivalent, me kusht që një produkt i tillë zgjidhet në përputhje me sa më poshtë vijon sipas rendit të përparësisë:

i) Prodhuuesi ka dorëzuar një kërkesë për miratimin e një produkti të tillë pranë Programit të Parakualifikimit të OBSH-së apo pranë një autoritetit kompetent rregullator dhe një produkt i tillë prodhohet në një vend që është në përputhje me standardet e GMP-së, i certifikuar (pas inspektimit) nga OBSH-ja apo nga një autoritet kompetent rregullator; ose

ii) Nëse prodhuuesi i një produkti të tillë nuk ka dorëzuar një kërkesë për miratimin e një produkti të tillë pranë Programit të Parakualifikimit të OBSH-së apo pranë një autoritetit kompetent rregullator, atëherë një produkt i tillë prodhohet në një vend që është në përputhje me standardet e GMP-së, i certifikuar (pas inspektimit) nga OBSH-ja apo nga një autoritet kompetent rregullator.

Përfituesi Kryesor do të njoftojë menjëherë me shkrim Fondin Global nëse ai prokuron ndonjë produkt në zbatim të kriterëve të dhëna në pikat i ose ii më sipër.

k) Analiza e Kontrollit të Cilësisë.

a) Përfituesi Kryesor do të sigurojë që kampionë të rastësishëm të Produkteve Farmaceutike Shumëburimëshe të përshkruar në pikën (i) më sipër dhe të financuar sipas kësaj marrëveshjeje testohen në mënyrë sistematike për qëllime të kontrollit të cilësisë në laboratorët e njohur nga OBSH-ja kur Autoriteti Kombëtar Rregullator i Barnave i Vendit Përfitues nuk ka kapacitete për të kryer analiza të tilla.

b) Përfituesi Kryesor do të sigurojë që kampionë të rastësishëm të Produkteve me Burim të Vetëm apo me Burim të Kufizuar dhe Produkteve të Tjera Farmaceutike të përshkruar në pikën (1) të nënparagrafit (j) më sipër dhe të financuar sipas kësaj marrëveshje testohen në mënyrë sistematike për qëllime të kontrollit të cilësisë në laboratorët që janë akredituar sipas Programit të Parakualifikimit të OBSH-së, kur Autoriteti Kombëtar Rregullator i Barnave i Vendit Përfitues nuk ka kapacitete për të kryer analiza të tilla.

c) Përfituesi Kryesor do të sigurojë që kampionë të rastësishëm të Produkteve me Burim të Vetëm apo me Burim të Kufizuar dhe Produkteve të Tjera Farmaceutike të përshkruar në pikën (2) të nënparagrafit (j) më sipër dhe të financuar sipas kësaj marrëveshjeje testohen në mënyrë sistematike për qëllime të kontrollit të cilësisë ose në (1) laboratorët e njohur nga OBSH-ja; ose (2) laboratorët që ndodhen në vendet e Konferencës Ndërkombëtare për Harmonizimin e Kërkesave Teknike të Regjistrimit të Barnave për Përdorim Njerëzor (KNH). dhe/ose të Skemës së Bashkëpunimit të Inspektimit Farmaceutik (SBIF);, kur Autoriteti Kombëtar Rregullator i Barnave i Vendit Përfitues nuk ka kapacitete për të kryer analiza të tilla.

d) Fondi Global do të kontrakttojë një palë të tretë të pavarur për të realizuar analizën e kontrollit të rastësishëm të cilësisë së produkteve që prokurohen në zbatim të kriterëve të dhëna në pikat i dhe ii të nënparagrafit më sipër për të garantuar cilësinë e produkteve të tilla. Përfituesi Kryesor do të lejojë (dhe do të sigurojë që Nën-përfituesit lejojnë) një palë të tillë të tretë (dhe/ose agjentët e saj) të hyjnë në depot e tyre dhe të marrin kampionë të produkteve të prokuruar në zbatim të kriterëve të dhëna në pikat i dhe ii të nënparagrafit më sipër për kryerjen e analizave të tilla. Gjithashtu, Përfituesi Kryesor do të sigurojë që kontratat e tij me furnizuesit e Produkteve Shëndetësore përfshijnë:

i) Të drejtën e Fondit Global për sa më poshtë vijon:

a) Të marrë specifikimet e prodhuesit,

b) Të marrë kampionë të produkteve për të realizuar analiza të rastësishme të kontrollit të cilësisë ndërkohë që produktet janë nën zotërimin e furnizuesit; dhe

c) Të bëjë publike rezultatet e analizave; dhe

ii) Të drejtën e Përfituesit Kryesor që t'i kthejë furnizuesit produktet që janë gjetur, pas kryerjes së një analize të tillë, se janë jashtë specifikimit.

l) Zgjidhja e Kontratave. Lidhur me produktin e blerë në zbatim të kriterëve të dhëna në pikat i dhe ii të nënparagrafit (j) më sipër, në rast se: (i) kërkesa e dorëzuar nga një prodhues pranë Programit të Parakualifikimit të OBSH-së apo autoritetit kompetent rregullator për miratimin e një produkti të tillë nuk është më nën shqyrtim; ose (ii) një palë e tretë e kontraktuar nga Fondi Global përcakton se cilësia e një produkti të tillë është e papranueshme, atëherë Përfituesi Kryesor duhet të zgjidhë menjëherë kontratën me prodhuesin furnizues për një produkt të tillë.

m) Kufizimi Kohor. Nëse Përfituesi Kryesor synon të blejë Produkte me Burim të Vetëm apo me Burim të Kufizuar dhe Produkte të Tjera Farmaceutike të përshkruara në pikat (i) dhe (ii) të nënparagrafit (j) më sipër, atëherë Përfituesi Kryesor duhet të kërkojë të negociojë të drejtën për të zgjidhur kontratën e prokurimit të produkteve të tilla sa më shpejt që të jetë e mundur për Përfituesin Kryesor në mënyrë që ai të blejë produkte që pëmbushin kriteret e dhëna në pikat (1) ose (2) të nënparagrafit (j) më sipër. Në çdo rast, kontratat për prokurimin e Produkteve me Burim të Vetëm apo me Burim të Kufizuar dhe Produkteve të Tjera Farmaceutike të përshkruara në pikat (i) dhe (ii) të nënparagrafit (j) më sipër do të kenë një afat maksimal që nuk kalon mbi 12 muaj.

n) Regjistrimi Kombëtar i Barnave. Nëse produktet farmaceutike të synuara për t'u përdorur sipas Programit kërkojnë miratimin e Autoritetit Kombëtar Rregullator të Barnave në Vendin Përfitues, atëherë produkte të tilla farmaceutike mund të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse atyre u është dhënë një miratim i tillë.

o) Monitorimi i Performancës së Furnizuesit. Përfituesi Kryesor do të monitorojë performancën e furnizuesve në lidhje me cilësinë e mallrave dhe të shërbimeve që ata furnizojnë

dhe do të dorëzojë në mënyrë elektronike pranë Fondit Global informacionin e mbledhur për ta publikuar në internet nëpërmjet një mekanizmi të krijuar apo të specifikuar nga Fondi Global.

p) Monitorimi i Cilësisë së Produktit. Përfituesi Kryesor dhe Fondi Global sigurojnë, mbështetur në diskrecionin e vet, në mënyrë sistematike që kampionët e rastësishëm të produkteve farmaceutike të financuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje analizohen për pajtueshmërinë e tyre me standardet e zbatueshme të cilësisë. Përfituesi Kryesor do të ketë në dispozicion sisteme të përshtatshme monitorimi që janë të pranueshme për Fondin Global ose do të sigurojë përdorimin e agjencive ndërkombëtare të prokurimit që janë të pranueshme për Fondin Global.

q) Zinxhiri i Furnizimit. Përfituesi Kryesor do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar besueshmërinë, efikasitetin dhe sigurinë optimale në lidhje me zinxhirin e furnizimit për të gjitha produktet farmaceutike dhe Produktet e tjera Shëndetësore të financuara në bazë të Programit.

r) Shmangja e Kundërshtive. Përfituesi Kryesor do të zbatojë dhe do të sigurojë që nën-përfituesit zbatojnë procedurat që do të shmangin kundërshtitë e Produkteve Shëndetësore të financuara nga Programi kundrejt qëllimit të synuar për të cilin është rënë dakord. Procedurat duhet të përfshijnë krijimin dhe mirëmbajtjen e një menaxhimi të besueshëm të inventarit, sistemet e kontrollit të stokut sipas metodës e para brenda e para jashtë, sistemet e brendshme të kontrollit, dhe strukturat e administrimit të mirë për të siguruar funksionim e mirë të këtyre sistemeve.

s) Zbatimi i Protokolleve të Trajtimit, të Rezistencës ndaj Ilaçeve dhe të Efekteve të Kundërta. Përfituesi Kryesor do të zbatojë mekanizma për sa me poshtë vijon:

i) Të inkurajojë pacientët që t'i përmbahen trajtimeve të rekomanduara (mekanizma të cilët përfshijnë por nuk kufizohen në kombinimet e dozës fikse, formulimet e llojit njëherë në ditë, paketa blister, si dhe edukim e mbështetje të barabartë;

ii) Të monitorojë dhe të kontrollojë rezistencën ndaj ilaçeve; dhe

iii) Të monitorojë reagimin e kundërt të ilaçeve sipas udhëzimeve ekzistuese ndërkombëtare.

I gjithë prokurimi i ilaçeve për të trajtuar turbekulozin, rezistent ndaj shumë ilaçeve, i financuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje duhet realizuar nëpërmjet Komitetit të Autorizimit të Partneritetit të Ndalimit Global të Turbekulozit.

t) Raportimi i Çmimit. Me marrjen në vend të Produkteve Shëndetësore të blera me fondet e Grantit, Përfituesi Kryesor duhet të raportojë menjëherë pranë Fondit Global për çmimet që ka paguar për Produkte të tilla Shëndetësore dhe për informacione të tjera në bazë të specifikimeve dhe duke përdorur formën e Mekanizmit të Raportimit të Çmimeve që është e disponueshme në faqen e internetit të Fondit Global apo një mjet tjetër të tillë të përshtatshëm që Fondi Global mund të vërë në dispozicion për këtë qëllim.

Neni 20

Sigurimi dhe përgjegjësia për humbjen, vjedhjen apo dëmtimin

a) Sigurimi. Përfituesi Kryesor do të bëjë, me një kosto të arsyeshme, sigurimin nga rreziqet ndaj pronësisë mbi asetet e Programit dhe sigurimin nga dëmet në përgjithësi me shoqëri sigurimesh financiarisht të fuqishme dhe me reputacion. Mbulimi me sigurim do të jetë në përputhje me atë që behet nga subjektet e ngjashme të angazhuara në aktivitete të krahasueshme.

b) Përgjegjësia për Humbjen ose Vjedhjen. Përfituesi Kryesor do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për humbjen, vjedhjen apo dëmtimin e çdonjërit apo të gjithë artikujve të blerë me fondet e Grantit (duke përfshirë ato nën posedimin e Nën-përfituesve), dhe, menjëherë sapo të ndodhë një humbje, vjedhje apo dëmtim i tillë, ai do t'i zëvendësojë artikujt e tillë me shpenzimet

e veta në përputhje me kërkesat e prokurimit të përcaktuara në Nenin 18 dhe Nenin 19 të kësaj Marrëveshjeje. Gjithashtu, Përfituesi Kryesor do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për humbjen apo vjedhjen e parave fizike nën zotërimin e Përfituesit Kryesor apo të ndonjërit nga agjentët e tij apo Nën-përfituesit dhe nuk do të bëjë rekurs ndaj Fondit Global për një humbje apo vjedhje të tillë.

Neni 21

Konflikti i interesit, antikorrupsioni

a) Standardet e Sjelljes. Përfituesi Kryesor do të ruajë dhe të zbatojë standardet e sjelljes për të administruar performancën e personave të lidhur me Përfituesin Kryesor apo Nën-përfituesin (për shembull, drejtorët, zyrtarët, punonjësit ose agjentët) të përfshirë në shpalljen e fituesve të kontratave, në grantet apo përfitimet e tjera ku përdoren fondet e Grantit për të garantuar që persona të tillë nuk angazhohen në asnjë praktikë të parashikuar në paragrafin (b) më poshtë.

b) Jo Korrupsion. Përfituesi Kryesor garanton se asnjë Nën-përfitues apo person i lidhur me Përfituesin Kryesor apo Nën-përfituesin:

i) Nuk merr pjesë në zgjedhjen, shpalljen e fituesit apo administrimin e një kontrate, granti apo përfitimi tjetër ose transaksioni të financuar nga Granti, në të cilin personi, personat e afërm të familjes së tij apo të saj ose ortakët e biznesit të tij apo të saj, organizatat e kontrolluara prej tij ose prej saj që e angazhojnë thellësisht një person të tillë, ka ose kanë një interes financiar;

ii) Nuk merr pjesë në transaksionet që përfshijnë organizatat apo subjektet, me të cilat personi është duke negociuar apo ka ndonjë gjë të organizuar lidhur me punësimin e ardhshëm;

iii) Nuk ofron, nuk jep, nuk kërkon apo nuk merr drejtpërsëdrejti apo jo drejtpërsëdrejti ryshfete, favore, dhurata apo gjë tjetër me vlerë për të influencuar mbi veprimin e cilitdo person të përfshirë në procesin e aplikimit apo të nënshkrimit të kontratës;

iv) Nuk jep fakte të reja dhe nuk heq fakte, me qëllim që të influencojë mbi procesin e prokurimit apo të nënshkrimit të një kontrate;

v) Nuk angazhohet në ndonjë skemë apo organizim ndërmjet dy apo më shumë ofertuesve, me ose pa dijeninë e Përfituesit Kryesor apo Nën-përfituesit, që janë krijuar për të caktuar çmimet e ofertave në nivele artificiale, jo-konkurrese; ose

vi) Nuk merr pjesë në asnjë praktikë tjetër e cila është apo mund të interpretohet si një praktikë e paligjshme apo e korruptuar në Vendin Përfitues.

c) Transparenca. Nëse Përfituesi Kryesor ka dijeni apo mëson rreth sa më poshtë vijon:

i) Ndonjë konflikti aktual, në dukje apo të mundshëm ndërmjet interesave financiare të çdo personi të lidhur me Përfituesin Kryesor, me çdonjërin prej Nën-përfituesve, me Mekanizmin e Koordinimit, me Agjentin Lokal të Fondit, ose me Fondin Global dhe detyrave të atij personi në lidhje me zbatimin e Programit; ose

ii) Ndonjë prej praktikave të renditura në paragrafin (b) më sipër, atëherë, Përfituesi Kryesor do t'i bëjë menjëherë të njohur drejtpërsëdrejti Fondit Global konfliktin aktual, në dukje apo të mundshëm të interesit.

Neni 22

Përdorimi i logove dhe i markave tregtare

Përdorimi i Logos dhe i Markave Tregtare të Fondit Global. Përfituesi Kryesor do të kërkojë që Nën-përfituesit e tij të mos përdorin logon apo markat tregtare, në qoftë se Përfituesi Kryesor dhe Nën-përfituesit e tij nuk kanë nënshkruar një marrëveshje të vlefshme për licencë me Fondin Global për një përdorim të tillë.

Neni 23

Zëvendësimi, transferimi i përfituesit kryesor

Nëse në çdo moment, qoftë Përfituesi Kryesor apo Fondi Global arrijnë në përfundimin

që Përfituesi Kryesor nuk është i aftë të kryejë rolin e Përfituesit Kryesor dhe të përmbushë përgjegjësitë e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, ose, nëse, për çfarëdo arsye, Fondi Global dhe Përfituesi Kryesor dëshirojnë të transferojnë disa apo të gjitha përgjegjësitë e Përfituesit Kryesor te një subjekt tjetër që është i aftë dhe dëshiron t'i pranojë këto përgjegjësi, atëherë subjekti tjetër ("Përfituesi Kryesor i Ri"), mund të zëvendësojë Përfituesin Kryesor të kësaj Marrëveshjeje. Zëvendësimi do të realizohet me ato terma për të cilat Fondi Global dhe Përfituesi Kryesor i Ri bien dakord, në konsultim me Mekanizmin e Koordinimit. Përfituesi Kryesor do të bashkëpunojë plotësisht me Fondin Global dhe me Mekanizmin e Koordinimit për të lehtësuar transferimin.

Neni 24

Përfitues të tjerë kryesorë

Përveç Përfituesit Kryesor, Fondi Global herë pas here mund t'u japë grante subjekteve të tjera për të zbatuar programe në Vendin Përfitues. Përfituesi Kryesor do të bashkëpunojë siç duhet me subjekte të tjera të tilla për të realizuar përfitimet e të gjitha programeve të financuara nga Fondi Global.

Neni 25

Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë, dokument, raport, apo komunikim tjetër i dorëzuar qoftë nga Përfituesi Kryesor, qoftë nga Fondi Global, për aq sa kjo Marrëveshje nuk përcakton ndryshe shprehimisht, do t'i dërgohet: (i) Përfaqësuesit të Autorizuar të palës tjetër të shënuar në bllokun 15 ose 16 të fletës së të dhënave të kësaj Marrëveshjeje, siç është e përshtatshme; ose (ii) Emrit/Adresës për Njoftime të palës tjetër të shënuar në bllokun 13 ose 14 të fletës së të dhënave të kësaj Marrëveshjeje, siç është e përshtatshme. Të gjithë dokumentet e tilla do t'i dërgohen për djepi Mekanizmit të Koordinimit. Në rastin e komunikimeve në drejtim të Fondit Global nëpërmjet Agjentit Lokal të Fondit, Përfituesi Kryesor do t'ia dorëzojë njoftimet e tilla personit të identifikuar në bllokun 12 të fletës së të dhënave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26

Zgjidhja, pezullimi, skadimi i kohëzgjatjes së programit

a) Zgjidhja e Vet e Fondit Global. Fondi Global mund ta zgjidhë apo pezullojë këtë Marrëveshje plotësisht ose pjesërisht, për çfarëdo arsye që e vendos në bazë të diskrecionit të vet, duke i dërguar Përfituesit Kryesor njoftim me shkrim. Çdo pjesë e kësaj Marrëveshjeje që nuk është zgjidhur apo pezulluar do të mbetet në fuqi të plotë.

b) Procedurat pas Përfundimit apo Skadimit të Kohëzgjatjes së Programit. Me zgjidhjen e plotë apo të pjesshme të kësaj Kontrate për çfarëdo arsye apo me mbarimin e Kohëzgjatjes së Programit, Përfituesi Kryesor, ndër procedurat e tjera që mund të kërkojnë nga Fondi Global, do të përmbushë sa më poshtë vijon:

i) Kthen menjëherë pranë Fondit Global të gjitha fondet e Grantit që nuk janë shpenzuar nga Përfituesi Kryesor dhe Nën-përfituesit deri në datën e njoftimit të zgjidhjes apo të datës së mbarimit të Kohëzgjatjes së Programit (sipas rastit), nëse kërkohet nga Fondi Global që të veprohet në këtë mënyrë;

ii) I dërgon Fondit Global një raport përfundimtar të kontrollit financiar të Programit;

iii) I dërgon Fondit Global një inventar të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të financuara me fondet e Grantit; dhe

iv) Nëse kërkohet nga Fondi Global, i dërgon një plan (të përgatitur në konsultim me mekanizmin e Koordinimit) për përdorimin e të gjitha aseteve dhe shërbimeve të përmendura në nënparagrafin iii më sipër ("Plani i Mbylljes"). Plani i Mbylljes do t'i nënshtrohet miratimit

përfundimtar të Fondit Global.

c) Transferimi. Me mbarrimin e Kohëzgjatjes së Programit apo me zgjidhjen me të hershme të Marrëveshjes, Fondi Global mund të udhëzojë, në bazë të Nenit 18 (e) të kësaj Marrëveshjeje, që titulli mbi çdo aset të Programit të transferohet te Fondi Global ose te një subjekt tjetër i caktuar nga Fondi Global.

Neni 27

Rifinancimet

Pavarësisht nga disponueshmëria apo ushtrimi i çdo rregullimi sipas kësaj Marrëveshjeje, Fondi Global mund t'i kërkojë Përfituesit Kryesor të rifinancojë menjëherë pranë Fondit Global çdo livrim të fondeve të Grantit në monedhën, në të cilën është bërë livrimi, secilin prej rasteve të poshtëshënuara:

- a) Kur kjo Marrëveshje është zgjidhur ose pezulluar;
- b) Kur ka pasur një shkelje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga ana e Përfituesit Kryesor;
- c) Kur Fondi Global i ka livruar gabimisht fonde Përfituesit Kryesor; apo
- d) Kur Përfituesi Kryesor ka bërë një paraqitje të rremë materiale lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje.

Neni 28

Kufijtë e përgjegjësisë së fondit global

a) Fondi Global do të jetë përgjegjës vetëm për plotësimin e detyrimeve që janë të përcaktuara në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje. Përveç këtyre detyrimeve, Fondi Global nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj Mekanizmit të Koordinimit (ose ndaj çdo anëtarit të tij), ndaj Përfituesit Kryesor, ndaj Nën-përfituesve, ndaj punonjësve apo kontraktorëve dhe ndaj çdo personi apo subjekti tjetër si pasojë e kësaj marrëveshjeje apo zbatimit të Programit. Çdo përgjegjësi financiare apo përgjegjësi të tjera që lindin si pasojë e zbatimit të Programit do të jenë përgjegjësi ekskluzive e Përfituesit Kryesor.

b) Përfituesi Kryesor zbaton programin në emër të Mekanizmit Koordinues dhe jo në emër të Fondit Global. Kjo Marrëveshje dhe Granti nuk do të interpretohen në asnjë mënyrë sikur krijojnë marrëdhënien e kryesorit dhe të agjentit, të ortakërisë apo të ndërmarrjes së përbashkët ndërmjet Fondit Global dhe Përfituesit Kryesor apo çdo personi tjetër të përfshirë në Program. Fondi Global nuk merr asnjë përgjegjësi që lind si pasojë e Programit për humbje apo dëmtim të shkaktuar ndaj personave apo pronës. Përfituesi Kryesor nuk do të prezantohet në asnjë rrethanë si agjent i Fondit Global, ndërkohë që do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të shmangur çdo perceptim duke treguar se një marrëdhënie e tillë nuk ekziston.

Neni 29

Dëmshpërblimi

Përfituesi Kryesor do të mbrojë, do të dëmshpërblejë dhe do të ruajë të padëmtuar Fondin Global, drejtorët e tij, zyrtarët dhe të punësuarit si dhe çdonjërin prej agjentëve të Fondit Global dhe kontraktorëve nga (i) ndonjë apo të gjitha humbjet e Fondit Global, të zyrtarëve dhe punonjësve të tij, dhe (ii) ndonjë apo të gjitha pretendimet, paditë e shkaktimit të dëmit, paditë penale (duke përfshirë akuzat, pagesat dhe tarifat e arsyeshme të avokatëve), procedimet, dëmtimet, shpenzimet dhe detyrimet e çdo lloji që mund të shkaktohen nga Fondi Global apo që mund të shpallen kundër Fondit Global, kundër zyrtarëve dhe punonjësve të tij, nga ose në emër të çdo personi për shkak të tyre, bazuar apo që rezulton nga dhe që vjen nga (ose që mund të pretendohet se vjen nga) veprimet dhe mosveprimet e Përfituesit Kryesor dhe të agjentëve, të punonjësve, të Nën-përfituesve, të përfaqësuesve, të të transferuarve, të të deleguarve apo të

pasardhësve të tij, për të cilët Përfituesi Kryesor mban përgjegjësi.

Neni 30

Letrat e zbatimit

Për të ndihmuar Përfituesin kryesor në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Fondi Global do të nxjerrë. Herë pas here, letra zbatimi që do të sigurojë informacion dhe udhëzime shtesë rreth çështjeve të shprehura në këtë Marrëveshje.

Neni 31

Ndryshimi ose amendimi

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk janë me shkrim dhe të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të Fondit Global dhe të një përfaqësuesi të autorizuar të Përfituesit Kryesor. Çdo ndryshim i termave të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në një letër zbatimi të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 32

Shpërndarja e informacionit

Përfituesi Kryesor është i ndërgjegjshëm se Fondi Global rezervon të drejtën që të botojë ose të shpërndajë lirisht informacionin e nxjerrë nga zbatimi i këtij Programi.

Neni 33

Mosheqja dorë nga mjetet ligjore

Asnjë vonesë në ushtrimin e një të drejte apo të një mjeti ligjor sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si heqje dorë nga një e drejtë apo mjet ligjor i tillë.

Neni 34

Pasardhësit dhe trashëgimtarët

Kjo Marrëveshjeje do të jetë detyruese për pasardhësit dhe trashëgimtarët e Përfituesit Kryesor dhe Marrëveshja konsiderohet se përfshin për pasardhësit dhe trashëgimtarët e Përfituesit Kryesor. Megjithatë, asgjë nga kjo Marrëveshjeje nuk do të lejojë ndonjë transferim pa miratimin paraprak me shkrim të Fondit Global.

Neni 35

Arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga Marrëveshja apo që është e lidhur me të, apo shkelja, zgjidhja apo pavlefshmëria nga kjo, do të zgjidhen nga arbitrazhi në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare (KKBDTN) që janë aktualisht në fuqi. Fondi Global dhe Përfituesi Kryesor pranojnë të jenë të detyruar të zbatojnë vendimin e arbitrazhit të dhënë në përputhje me një arbitrim të tillë si gjykimi përfundimtar i çdo mosmarrëveshjeje, kundërshtie apo pretendimi. Autoriteti emërtues për një arbitruer të tillë do të jetë Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Numri i arbitruesve do të jetë tre. Vendi i Arbitrimit do të jetë Gjeneva e Zvicrës. Gjuha që do të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jenë në Anglisht.

Neni 36

Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga Parimet e Institutit Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (INU DP) (2004).

Neni 37

Marrëveshja në tërësi

Kjo Marrëveshje së bashku me anekset dhe me pjesët shtojcë të saj përbejnë të gjithë Marrëveshjen ndërmjet Palëve dhe parashtrojnë kushtet, ujditë dhe marrëveshjet ndërmjet palëve që i përmbahen kësaj Marrëveshjeje dhe suprimon të gjitha marrëveshjet, ujditë, negociatat dhe diskutimet qoftë me gojë e qoftë me shkrim. Nuk ka kushte, ujdë apo marrëveshje të tjera, me gojë ose me shkrim, të shprehura, të nënkuptuara apo garanci shtesë ndërmjet Palëve në lidhje me përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje përveç atyre të parashikuara në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje dhe në pjesët shtojcë të saj.

Neni 38

Data e hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje e përgatitur në dy kopje origjinale do të hyjë në fuqi në datën e firmosjes së saj nga të dy, Përfituesi Kryesor dhe Fondi Global, që veprojnë nëpërmjet Përfaqësuesve të Autorizuar sipas rregullit të identifikuar në blloqet 15 dhe 16 të fletës të së dhënave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 39

Ekzistenca

a) Të gjitha pranimet, marrëveshjet, përfaqësimet dhe garancitë e bëra nga Përfaqësuesi Kryesor në këtë Marrëveshje do të konsiderohen se janë besuar nga Fondi Global dhe do të ekzistojnë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga ndonjë hetim i kryer nga Fondi Global apo nga ndonjë subjekt në emër të tij dhe pavarësisht që Fondi Global mund të ketë pasur njoftim ose dijeni për ndonjë fakt apo paraqitje të rremë ose garanci në ndonjë moment të Kohëzgjatjes së Programit, dhe do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në Datën e Përfundimit të Fazës 1 ose, nëse është dhënë Miratimi i Fazës së Dytë nga Fondi Global, deri në Datën e Përfundimit të Fazës 2.

b) Dispozitat e Nenit 6 (Marrëveshjet e Përfituesit Kryesor), të Nenit 8 (Agjenti Lokal i Fondit), të Nenit 9 (Menaxhimi i Fondeve të Grantit), të paragrafëve (a), (f) dhe (g) të Nenit 13 (Kontrollet dhe Dokumentet Kontabël), të paragrafit (c) i Nenit 15 (Raportet Programatike të Progresit), të Nenit 17 (Vlerësimet nga Fondi Global), të Nenit 18 (Kontratat për Mallrat dhe Shërbimet), të Nenit 19 (Produktet Farmaceutike dhe Produktet e tjera Shëndetësore), të Nenit 20 (Sigurimi dhe Përgjegjësia për Humbjen, Vjedhjen ose Dëmtimin), të Nenit 21 (Konfliktet e Interesit; Anti-Korrupsioni), të Nenit 27 (Rifinancimet), të Nenit 28 (Kufijtë e Përgjegjësisë së Fondit Global) dhe të Nenit 29 (Dëshmipërblimi) do të ekzistojnë dhe do të mbeten në fuqi të plotë pavarësisht mbarimit të Kohëzgjatjes së Programit apo zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 40

Partnerët

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet nga një apo më shumë ortakë, por që të gjithë janë subjekte të së njëjtës kontratë.

Neni 41
Privilegjet dhe imunitetet

a) Asgjë në këtë Marrëveshje apo e lidhur me të nuk mund të interpretohet si një heqje dorë, e shprehur apo e nënkuptuar, nga privilegjet dhe imunitetet që i janë dhënë Fondit Global në bazë të (i) së drejtës ndërkombëtare duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare zakonore, konventat, traktatet apo marrëveshjet ndërkombëtare, (ii) të drejtat kombëtare duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në Aktin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Imunitetet e Organizatave Ndërkombëtare (22 Kodi i Shteteve të Bashkuara 288), ose (iii) Marrëveshjen e Selive ndërmjet Fondit Global dhe Këshillit Federal Zviceran të datës 13 Dhjetor 2004.

b) Përfituesi Kryesor do të bëjë përpjekjet e tij maksimale, bazuar në kërkesën e Fondit Global, që të sigurojë njohjen e Fondit Global nga ana e Vendit Përfitues si një institucion të cilit i përkasin privilegjet dhe imunitetet që normalisht i jepen organizatave ndërkombëtare.

Neni 42
Administratori

Fondi Global dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) kanë nënshkruar një marrëveshje me anë të së cilës Banka Botërore ka rënë dakord që të krijojë “Fondin e Administrimit të Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, Turbekulozin dhe Malarien” (Fondi i Administrimit) dhe të shërbejë si administrator i Fondit të Besimit (Administratori). Të gjitha detyrimet e Fondit Global në bazë të kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të Fondit Global dhe Banka Botërore nuk ka asnjë përgjegjësi morale për detyrimet e Fondit Global sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 43
Shkurtime

Kur përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë Përshkrimin e Zbatimit të Programit dhe çdo aneks apo pjesët shtojcë të kësaj Marrëveshjeje) shkurtime të mëposhtme kanë kuptimin e përshkruar më poshtë:

Shkurtimi	Kuptimi
TKA	Terapi e Kombinuar e Bazuar në Artemisininë
SIDA	Sindromi i Mungesës së Imunitetit të Fituar
KPN	Klinikë Prenatale
TAR	Terapi Antiretrovirale
ARV	Antiretrovirale
KNS	Komunikim i Ndryshimi të Sjelljes
SVS	Sondazh i Vëzhgimit të Sjelljes
OBK	Organizimi i Bazuar në Komunitet
MK	Mekanizëm i Koordinimit
SIRV	Sistem i Informacionit të Reagimit të Vendit
PST	Punëtor Seksi Tregtar
KA	Këshillim dhe Analizim

DDT	Diklorodifeniltrikloroetan
DMBZHN	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
VDSH	Vrojtime Demografike dhe Shëndetësore
TVDKS	Trajtim i Vëzhguar Direkt, Kurs i Shkurtër
VRI	Vëzhgim i Rezistencës ndaj Ilaçeve
TSI	Testim i Sensibilitetit të Ilaçit
ORB	Organizatë e Bazuar te Besimi
KDGJ	Komiteti i Dritës së Gjellbër (i Autorizimit)
GTZ - BTGJ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
TASHA	Terapi Antiretrovirale Shumë Aktive
PKSH	Punonjës i Kujdesit Shëndetësor
SISH	Sistem i Informacionit Shëndetësor
HIV - VMINJ	Virusi i Mungesës së Imunitetit Njerëzor
PDI	Përdorues Drogë me Injeksion
EKI	Edukim dhe Komunikim Informacioni
IPN	Trajtim Parandalues me Ndërprerje
SBM	Spërkatje e Brendshme me Mbetje
RRTI	Rrjetë e Trajtuar me Insekticide
VNJQP	Vrojtim i Njohurive, Qëndrimeve dhe Praktikave
ALF	Agjent Lokal i Fondit
RRJTI	Rrjetë Jetëgjatë e Trajtuar me Insekticide
OZHMKB	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara
RSHI	Rezistent ndaj Shumë Ilaçeve
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
GRMV	Grupi i Referencës së Monitorimit dhe Vlerësimit
VGSH	Vrojtim Grupi me Shumë Tregues
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BBSB	Burrat që Bëjnë Seks me Burrat
KKS	Komitetit Kombëtar i SIDA-s
PKS	Programi Kombëtar i SIDA-s
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PKKM	Programi Kombëtar i Kontrollit të Malaries
PKKT	Programi Kombëtar i Kontrollit të Tuberkulozit
IF	Infeksion i Fshehur
JVS	Jetimët dhe fëmijët e kthyer në vulnerabile nga SIDA
OSHPA	Organizata Shëndetësore Pan Amerikane
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
PPE	Profilaksi Pas Ekspozimit
PTNTF	Parandalimi i Transmetimit nga Nëna te Fëmija
PJMS	Persona që jetojnë me HIV/SIDA

PTPTF	Parandalimi i Transmetimit nga Prindi te Fëmija
PK	Përfitues Kryesor
RM	Reduktimi i Malariae
MKR	Mekanizmi i Koordinimit Rajonal
ASHD	Analizë e Shpejtë Diagnostikimi
NP	Nën-përfitues
SST	Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme
STI	Infeksion Seksualisht i Transmetueshëm
TB	Tuberkulozi
PPKBHS	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për HIV/SIDA-n
KKBDTN	Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare
PZHKB	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
OASHKKB	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
FPKB	Fondi për Popullsinë i Kombeve të Bashkuara
SVAPKB	Sesioni i Veçantë i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara
FKBF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
INUDP	Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private
ASHBZHN	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
KTV	Këshillim dhe Testim Vullnetar
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
SOBSHVP	Skema e Organizatës Botërore e Shëndetësisë për Vlerësimin e Pesticideve

